

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81783

246

RREGULLAT E PIKËSIMIT

NË GJUHËN LETRARE SHQIPE
(PROJEKT)


Tiranë, 1981

4
246

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

**RREGULLAT E PIKËSIMIT
NË
GJUHEN LETRARE SHQIPE**

(PROJEKT)



Tiranë, 1981

PARATHËNIE

«Rregullat e pikësimit në gjuhën letrare shqipe», që po u jepen punonjësve të shkencës, të kulturës, të arsimit etj., janë paraqitja e parë e plotë e tyre në gjuhën shqipe.

Kristalizimi i normës letrare në të gjitha hallkat, sidomos në strukturën gramatikore, i arritur këto 35 vjetët e pushtetit popullor, kërkon edhe një pikësim të njësuar dhe të qëndrueshëm. Ishte kjo arsyeja që Kongresi i Drejtshkrimit shtroi detyrën për hartimin e rregullave të pikësimit, të cilat, nga ana e tyre, do të ndihmonin në kodifikimin e plotë të normave të gjuhës letrare në variantin e saj të shkruar.

Sistemi i pikësimit i gjuhës shqipe ka ngjashmëri me sistemet e gjuhëve të tjera që përdorin alfabetin latin ose alfabetin cirilik, kryesisht në karakterin e numrin e shenjave të pikësimit dhe në vlerën e tyre të përgjithshme. Kështu, pika, pikëpyetja, pikëçuditja përdoren për të treguar përfundimin e fjalisë a të periudhës; presja përdoret për të ndarë a për të veçuar gjymtyrë të një fjalie ose fjali të një periudhe; dy pikat paralajmërojnë diçka që do të thuhet, ose sqarojnë diçka që është thënë etj. Po përdorimi i tyre në raste konkrete në gjuhë të ndryshme për shkak të specifikës dhe të traditës së tyre nuk është gjithnjë i njëjtë. Dallime ka, p.sh., në përdorimin e presjes për ndarjen e fjalive të varura që ndodhen pas kryesores, dhe në raste të tjera. Në këtë kuptim përdorimi i shenjave të pikësimit në gjuhën shqipe ka veçoritë e veta.

Sistemi ynë i sotëm i pikësimit është rezultat i një për-

punimi të gjatë, ai është zhvilluar e saktësuar me zhvillimin e gjuhës së shkruar letrare shqipe. Rregullat e pikësimit që po paraqiten, saktësojnë, plotësojnë e kodifikojnë më tej këtë traditë tashmë të formuar.

Shenjat e pikësimit janë të domosdoshme për të ndarë e për të paraqitur saktë mendimet me shkrim. Mungesa ose përdorimi jo i drejtë i tyre vështirëson kuptimin e tekstit ose shpesh mund të japë shkas për keqkuptime.

Shenjat e pikësimit kanë rëndësi të veçantë sidomos në ato raste kur mjetet leksikore e sintaksore nuk janë të mjaftueshme për të dhënë qartë lidhjen e fjalëve e të fjalive. Është pikërisht presja që na tregon se ndajfolja *dje* në shembullin *Dritarja ku ishte vendosur vazoja me lule dje ishte e hapur* lidhet me foljen *ishte vendosur* apo me foljen *ishte*. Në pajtim me atë që duam të themi, presjen mund ta vendosim pas ndajfoljes *dje* e ta lidhim me foljen e parë ose para ndajfoljes *dje* e ta lidhim këtë me foljen e dytë.

Shenjat e pikësimit mund të jenë të vetmit tregues të marrëdhënieve ose të nuancave kuptimore që vendosen ndërmjet fjalive. Një fjali që s'ka fjalë pyetëse ose pasthirmë, mund të kuptohet në është dëftore, pyetëse apo thirrmore nga shenja e pikësimit që ka në fund të saj. Mospërdorimi i presjes para fjalisë përcaktore në shembullin *Nxënësit e shkollës sonë që u kthyen mbrëmë nga aksioni, ishin tërë gaz e hare* tregon funksionin përcaktor dallues të fjalisë së varur (ishin tërë gaz e hare pikërisht nxënësit që u kthyen nga aksioni, jo të tjerë); në këtë periudhë fjalia përcaktore jep diçka që nga pikëpamja e kuptimit është e domosdoshme për konkretizimin e emrit të përcaktuar. Përdorimi i presjes para fjalisë përcaktore: *Nxënësit e shkollës sonë, që u kthyen mbrëmë nga aksioni, ishin tërë gaz e hare* tregon funksionin përcaktor sqarues, shtesor të fjalisë së varur (duke përcaktuar, ajo sqaron një rrethanë, shton që të gjithë nxënësit ishin në aksion, pra nuk i dallon); fjalia përcaktore në këtë rast nuk e konkretizon emrin e përcaktuar, sepse ai del si i tillë nga konteksti ose nga situata. Në ligjërimin e folur këto nuanca shprehen me anë të intonacionit, i cili është i ndryshëm: në rastin e parë vija melodike nga gjymtyra e përcaktuar në fjalinë përcaktore nuk thyhet dhe ka një theksim më të madh të fjalisë përcaktore; në rastin e dytë vija

melodike thyhet nga ulja e tonit në fund të gjymtyrës së përcaktuar e nga një pushim para fjalisë përcaktore, e cila nuk theksohet.

Edhe në rastet kur mjetet leksikore e sintaksore janë të mjaftueshme për të dhënë qartë marrëdhëniet kuptimore e nuancat, shenjat e pikësimit e bëjnë më të kapshme strukturën e fjalisë a të periudhës.

Parimi kryesor mbi të cilin mbështetet pikësimi ynë, është parimi sintaksor. Kjo duket si në synimin e pikësimit për ta bërë sa më të kapshme strukturën sintaksore të shqipes (për të ndarë fjalitë e periudhat nga njëra-tjetra dhe për të ndarë e veçuar fjalitë në periudhë e gjymtyrët e fjalive), edhe në formulimin e rregullave sipas kategorive të ndryshme sintaksore.

Parimi sintaksor gërshetohet edhe me parimin intonacionor. Struktura sintaksore dhe intonacioni nuk ekzistojnë në ligjërime të ndarë. Ata të dy janë mjete me anën e të cilave organizohet materiali leksikor për të shprehur marrëdhënie të ndryshme kuptimore e nuanca të ndryshme. Me këtë shpjegohet që shenjat e pikësimit në shumicën e rasteve gjejnë mbështetje edhe te struktura sintaksore, edhe te intonacioni: te ulja e tonit pas një gjymtyre a pas një fjalie, te pushimet që vendosen midis gjymtyrëve a fjalive, te theksimi i fjalëve të veçanta etj. (shih për këtë përdorimin e presjes te tipat e ndryshëm të periudhave me fjali të varur pas kryesores). Po duhet thënë që shenjat e pikësimit nuk pasqyrojnë gjithnjë në mënyrë besnike intonacionin. Jo çdo pushim që vendoset midis gjymtyrëve të fjalisë në ligjërimin e folur, jepet me presje në ligjërimin e shkruar. P.sh., midis grupit të kryefjalës dhe grupit të kallëzuesit nuk vihet presje, megjithëse midis tyre bëhet një pushim i shkurtër në ligjërimin e folur. Jepen me presje pushimet midis gjymtyrëve ose fjalive që mbështeten edhe në strukturën sintaksore të ligjëritimit e që ndihmojnë në kapjen e kuptimeve e të nuancave kuptimore. Në raste të tjera presja mund të mos pasqyrojë një pushim në ligjërimin e folur, ajo mund të përdoret thjesht për arsye sintaksore, si p.sh., presja midis dy lidhëzave kur një fjali e varur futet në mes të një fjalie të bashkërenditur ose të nënrenditur: *Një stërqokë u ngrit nën këmbët e tij dhe, pasi i fluturoi mbi kokë, zuri vend mbi një shtyllë aty pranë.*

Vranakonti kishte urdhër që, posa të dilte kalorësia e Hamzait nga pusia për t'i marrë krahët armikut, ai t'i godiste turqit përballë.

Duke qenë se rregullat e pikësimit janë kodifikim i traditës së formuar nga përdorimi i gjatë i shenjave të pikësimit, ato kanë një karakter të theksuar normativ: janë pranuar prej të gjithëve dhe duhet të zbatohen prej të gjithëve. Po karakteri normativ i rregullave të pikësimit nuk duhet të kuptohet në mënyrë të ngurtë. Sidomos në letërsinë artistike, ku përsëritjen e analizohen dukuri të ndryshme shoqërore, marrëdhënie të ndërlikuara njerëzore, ndjenja të forta shpirtërore, shenjat e pikësimit përdoren shpesh si mjete të ligjërit të shkruar për të dhënë atë anë të përmbajtjes që nuk jepet në mënyrë shprehëse me mjete të tjera. Pikëçuditja dhe tri pikat në këtë shembull: DOM MARKU — *Dikush po ia çart mendjen këtij djali!*... (ku mund të vihej edhe vetëm pika) janë përdorur me vlerë shprehëse-emocionale, për të dhënë keqardhjen hipokrite të priftit për një malësor që nuk i beson më dhe që këtë mosbesim e tregon hapur para malësorësh të tjerë. Me vlerë stilistike përdorin shpesh shkrimtarët presjen për të vënë më shumë në dukje gjymtyrë të fjalisë, pikën për të ndarë më dysh një periudhë me bashkërenditje ose me nënrenditje etj. Po kushdo duhet ta ketë të qartë se përdorimi i shenjave të pikësimit me këtë vlerë duhet të jetë në pajtim me ndarjen kuptimore e gramatikore të ligjërit.

«Rregullat e pikësimit» janë ndarë në kapituj sipas shenjave të pikësimit, po numërimi i paragrafëve është bërë vijueshëm. Rregullat e përdorimit të çdo shenje janë formuluar sipas kategorive gramatikore dhe me termat më të përgjithshëm të sintaksës së shqipes. Vetëm te thonjëzat dhe te kllapat ky parim edhe thyhet për ta dhënë më të plotë përdorimin e tyre. Sidomos te presja janë formuluar në të njëjtin paragraf edhe rregullat e mospërdorimit të saj duke i dhënë përparësinë asaj ane që është tipike për atë kategori. Te kapitulli i pikës dhe i kllapave të rrumbullakëta është dhënë pas tri pikash edhe përdorimi i tyre si shenja grafike.

«Rregullat e pikësimit» u diskutuan në një mbledhje të zgjeruar të këshillit shkencor të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Autorët falënderojnë për vërejtjet e sugjerimet

e tyre të vlefshme të gjithë ata që morën pjesë në diskutim, në mënyrë të veçantë recenzentët E. Lafe e S. Mancaku.

«Rregullat e pikësimit» po botohen si maket. Ato do t'i nënshtrohen një diskutimi të gjerë në qendër dhe në rrethe para se të marrin një formë përfundimtare. Autorët mendojnë se një kontribut të madh në përmirësimin e plotësimin e mëtejshëm të këtyre rregullave duhet të japin arsimtarët e gjuhës dhe të letërsisë, si edhe redaktorët letrarë të shtëpive botuese, të gazetave e revistave të ndryshme, të cilëve praktika e përditshme u sugjeron raste nga më të ndryshmet të përdorimit të shenjave të pikësimit. Ata do të mirëpresin çdo vërejtje e sugjerim.

PIKA (·)

Pika shënon mbarimin e një fjalie të mëvetësishme ose të një periudhe që nuk shqiptohet as me intonacion pyetës, as me intonacion thirrmos. Në ligjërimin e folur asaj i përgjigjet një pushim relativisht i gjatë midis fjalive a periudhave.

§ 1. Vihet pikë në fund të një fjalie dëftore (të plotë a të paplotë), si edhe në fund të një periudhe me fjali dëftore të bashkuara pa lidhëza ose me lidhëza bashkërenditëse:

Mbi këto themele po ngrihej Shqipëria e re, e pavarur, demokratike.

(— Ku gjendet ajo tani?) — *Në Vlorë.*

Armiku kishte katër herë më shumë forca e, megjithatë, s'e theu dot grupin partizan.

Do të shërohej, s'kish asnjë dyshim.

Plani i atij ishte i qartë: të shtonte radhët e çetës e të çlironte Malin e Shqipës.

Vihet pikë edhe pas një fjale a togu fjalësh me vlerën e një fjalie emërore ose pas një pjesëze po ashtu me vlerën e një fjalie kur nuk shqiptohen me intonacion pyetës a thirrmos:

Duartrokitje. Buzëqeshje.

Shpërthime të qeshurash në sallë.

Qendër banimi e brigadës së shpimit. Baraka prej dërrasash.

(— Për Arbenin e ke fjalën?) — *Po.*

§ 2. Vihet pikë në fund të periudhave me fjali të varura prej fjalish kryesore dëftore:

Nata ish aq e errët, sa shpesh u bëhej sikur po kalonin nëpër një tunel.

Këtë vendim s'ia kishte thënë as Adnanit kur e kishte lajmëruar që të përgatitej për mbledhjen e Partisë, ku do të merrej në shqyrtim pranimi i tij.

Më në fund, i ishte mbushur koka të takohej me ndonjë nga shokët, t'ia kallëzonte të gjitha e të merrte mendimin e tij.

Kur shokët kooperativistë e caktuan si brigadierin e tyre, atij iu rrit ndjenja e përgjegjësisë, iu shtua guximi, iu shumëfishuan forcat fizike e morale.

Plakës diç i kishte zënë veshi; do të krijohej një parti, me të cilën komunistët do të ngrinin popullin më këmbë dhe do ta hidhnin në luftë kundër fashizmit dhe shërbëtorëve të tij.

§ 3. Përdoret pika edhe në fund të një fjalie të mëvetësishme nxitëse jothirrmore (që nuk shqiptohet me intonacion thirrmor), në fund të një periudhe me fjali të tilla të bashkuara pa lidhëza a me lidhëza bashkërenditëse, si edhe në fund të një periudhe me fjali të varura prej fjalish kryesore të tilla. Kjo ndodh sidomos kur fjalia nxitëse shpreh këshillë, porosi, propozim, lejim ose pranim:

Dëgjomë mua.

T'i doni lulet.

Shkojmë në një vend tjetër.

Le të vijë.

Le të dëgjojmë tani e pastaj le t'i diskutojmë edhe propozimet tona.

Flitni, le të shfaqë secili pa druajtje mendimin e vet.

Po pushoni, more shokë, se nuk po e marrim vesh nga vjen zhurma.

§ 4. Vihet pikë edhe në fund të një fjalie të mëvetësishme dëshirore jothirrmore, në fund të një periudhe me fjali të tilla të bashkuara pa lidhëza a me lidhëza bashkërenditëse ose në fund të një periudhe me fjali të varura prej fjalish kryesore të tilla:

U lumshin duart punëtorëve të ndërtimit.

Dhe tani mirë mbetsh dhe të ndjefsha zërin e mirë.

Këta të paçin më qafë, po të ngjau gjësendi.

Shënim. Mund të vihesh pikë edhe në fund të një periudhe të gjatë me një fjali pyetëse ose dëshirore thirrmore si fjali kryesore,

nëse kjo është e ndjekur nga shumë fjali të varura, kështu që intonacioni pyetës a thirrmos sa vjen e dobësohet e s'ndihet më në fund të periudhës (shih § 20,32):

Ah, sikur t'ia delte të ndihmonte të tjerët që të ndreqnin atë gabim që s'kishte arritur ta ndreqte ai për vete.

Po ç'ishte ajo forcë që e mbante plakun të mos përmbyses mbi zjarr, po të qëndronte ashtu, as shtrirë, as më këmbë, gati për t'u zgjuar, me të ndier mungesën e afshit e të flakës.

§ 5. Vihet pikë në fund të një periudhe me pyetje të zhdrejtë:

Ai vetë s'e kuptoi dot ç'e ngriti më këmbë,

Pyete kur do të vijë.

§ 6. Mund të vihet pikë edhe para një lidhëze bashkërenditëse ose edhe para një lidhëze nënrenditëse, duke u ndarë kështu në dy pjesë një periudhë për arsye kryesisht stilistike, kur kërkohet të vihet më shumë në dukje pjesa e dytë e saj (ndonjëherë edhe kur periudha është shumë e gjatë):

Mjaftonte që ekspedita t'ua bënte një kërkesë të tillë. Mirëpo ajo deshi të bënte gjithëka me duart e veta.

Ai shkruante, midis të tjerash, edhe për këtë. Por kjo nuk ishte kryesorja.

Binte shi. Kurse ata vazhdonin bisedën.

Dhe unë u jepja të drejtë atyre. Dhe s'i kritikojta.

Lirinë mund ta kishit fituar me trimërinë tuaj dhe me një tjetër çlirimtar, se Shqipërisë nuk i mungojnë burrat, po ju pëlqeu ta pritni nga dora ime, ndonëse vonë, se kështu ndoshta e solli rasti. Se është me të vërtetë çudi që trima kryelartë si ju, të rritur në liri, duruat kaq kohë robërinë e barbarëve duke pritur të më shikoni një ditë në krye tuaj.

Unë u kisha thënë pastrueseve që asgjë të mos preknin në tavolinë, edhe sikur të gjenin copa letrash të parëndësishme; edhe ato ashtu bënë. Kështu që e kisha fjetur se askush nuk i prekte letrat e mia. Prandaj mendova se letrën e zhubrosur do ta kisha vënë vetë mbi shtrat.

Ai ishte i qetë. Sikur s'kishte të bënte me këto fletë.

Shënim. Ndarja me pikë (si njësi më vete) e një fjalie ose e një togu fjalish me lidhje bashkërenditëse ndodh më shpesh në fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat *pra, prandaj, andaj, megjithatë, kurse, mirëpo, po*, sidomos kur është e gjatë pjesa e parë ose e dytë e periudhës. Gjithashtu në periudhën me nënrenditje mund të ndahet me pikë një fjali e varur — më shumë një fjali shkakore a rrjedhimore — që ndiqet ose jo nga fjali të tjera dhe nis me lidhëzat

sepse, se, kështu që. Rastet e tjera të vënies së pikës para lidhëzash bashkërenditëse e nënrenditëse janë më të rralla. Ato mund të jenë të pranueshme vetëm kur ka arsye të forta stilistike spikatjeje, theksimi.

§ 7. Me anë të pikës, po ashtu, për ta vënë në pah, për të arritur efekte stilistike, mund të ndahet nga fjalia edhe një gjymtyrë ose një tog gjymtyrësh:

Oborri u mbush me këngë. Pastaj me valle.

Qeshën. Me të madhe.

Trokasin në derë të Gëzimit. Disa herë me radhë.

Erdhi muaji i fundit i shekullit që po mbaronte. Pastaj java e fundit.

Zuri të ecte. Disi i hallakatur, disi i menduar.

Këmbët i kishte të rënda. Plumb të rënda.

Petriti u tregua me të i përzemërt. Bile më i përzemërt se zakonisht.

Dhe sigurisht ky takim do t'i sillte diçka të re. Të paktën një lajm, një shpresë ose një udhëzim. Diçka përfundimtare.

§ 8. Pika mund të përdoret edhe në shtjellimet numëruese për të ndarë fjali dëftore ose nxitëse jothirrmore që nisin me kryeradhë dhe kanë në krye një fjalë a thënie të përbashkët, me kuptim të përgjithshëm, të ndjekur nga dy pikat; në raste të veçanta mund të përdoret edhe për të ndarë gjymtyrë të një lloji, shumë të zgjeruara, në të njëjtat kushte:

Për këtë:

Të luftohet për një zhvillim të mëtejshëm të industrisë duke përmirësuar strukturën e saj me degë e prodhime të reja sidomos të industrisë së rëndë përpunuese, për zgjerimin e bazës energjetike dhe të lëndëve të para, për shfrytëzimin racional të burimeve e të pasurive të vendit.

Të arrihet një rritje më e madhe e prodhimit bujqësor nëpërmjet intensifikimit të mëtejshëm të tij, duke u mbështetur në forcimin e organizimit e të drejtimit shkencor të prodhimit dhe në fuqizimin e bazës materiale.

Miratohen pa ndryshim dekretet:

Nr. 4998 datë 1.7.1972 «Mbi një ndryshim në ligjin për sigurimet shoqërore të Republikës Popullore të Shqipërisë».

Nr. 5009 datë 10.11.1972 «Mbi arbitrazhin shtetëror».

Shënim. Në të tilla raste përdoret edhe pikëpresja (shih. § 91) Përdoret më shpesh pika nëse gjymtyrët e numërimit janë shumë të zgjeruara. Vihet vetëm pikë kur njëra prej tyre përbëhet prej fjalish të ndara me pikë.

§ 9. Në fund të fjalive a të periudhave të ndërkallura dëftore të vendosura brenda kllapash nuk vihet pikë:

Priti një farë kohe në heshtje (edhe një sekondë i dukej e gjatë dhe pa mbarim), pastaj, i lehtësuar, ngriti piramidën e arkave.

Po fëmijët erdhën njëri pas tjetrit (nja dy i vdiqën të vegjël) dhe nuk e lanë t'i bëhej krah të shoqit.

Sa kishte thënë pjesën e parë të kësaj fraze të gjatë (jemi të detyruar ta quajmë të gjatë, sepse është vënë re që, sa më të mëdha të jenë kantieret, aq më të shkurtra janë frazat), fytyra e Palit u bë menjëherë serioze dhe e menduar.

Shënim. Pas kllapës mbyllëse përdoret po ai pikësim që do të vihej, edhe po të mos ishte fjalia a periudha e ndërkallur, pra pikësimi që kërkon lidhja në mes pjesëve të fjalisë a të periudhës para dhe pas kllapave.

§ 10. Vihet pikë në fund të një fjalie të mëvetësishme dëftore të ndërkallur a të një periudhe të tillë kur kërkohej të dalë relativisht e shkëputur nga fjalia që ka përpara, prej së cilës ndahet me pikë, pikëpyetje a pikëçuditje, dhe nga fjalia që vjen pas; në të tilla raste fjalia a periudha në kllapa fillon me shkronjë të madhe:

Nuk do të ndodhë asgjë. (Kjo vlejti si përgjigje për dyshimet e Arbenit.) Fundja, unë kërkoj nga ju të më ndihmoni.

Sidoqoftë, plaku doli nga spitali dhe ai mbeti sërish vetëm. (Por të mos harrojmë se plaku tetëdhjetëvjeçar kishte lënë pas hijen e trupit të tij të gjatë, me energjinë dhe dëshirën për t'u kthyer medoemos pranë bletëve.) E meqë mbeti vetëm në dhomë, filloi të ëndërronte.

Vihet pikë edhe në fund të fjalive të mëvetësishme a të periudhave të vendosura në kllapa në veprat skenike (fjali a periudha që japin gjestet e personazheve, situatat etj.):

Gjyshja — Po, për bujqësi. (Lë dhiskun në vend dhe ulet pranë Shqipes.) E zgjodhi vetë.

Dhora — Ja erdha. (Hyn në kuzhinë.)

Gjyshja — Më rrofsh! Të lumçin duart! (Fut dorën në çantën që ka marrë nga varësja, dhe i jep një mollë.) Urdhëro një mollë nga të xhaxhamadhit.

Shënim. Nuk vihet pikë (dhe asnjë shenjë tjetër pikësimi), në qoftë se të dhënat skenike kanë formën e një fragmenti fjalie ose të një fjalie të varur:

Olimbia — (E alarmuar) E, sa i dhe?

Sofia — (Pasi pi ujin) Thashë se vdiqa.

§ 11. Kur pas fjalisë dëftore të mëvetësishme ose pas periudhës me fjali dëftore, vjen, i vendosur në kllapa, referimi i burimit të thënies, pika (ose pikëpyetja a pikëçuditja) vihet pas kllapave:

*Fëmija dukej e zhdukej nëpër degët e holla të qershive (T. Laço).
Kjo është historia më e vjetër e Skënderbeut në latinisht, ashtu siç u shkrua prej autorit të saj (F. Noli, Historia e Skënderbeut, 1921, f.9-10).*

Vihet pikë pas referimit burimor të një thënieje dhënë në fund të faqes; po kështu edhe në rreshtimet bibliografike:

A. Xhuvani, Naimi si poet e prozator, «Studime gjuhësore», Tiranë, 1956.

FRASHËRI, S: Shkronjëtoe e gjuhës shqip, Bukuresht, 1886.

§ 12. Vihet pikë (ose pikë e vizë) pas titullit të një nënkapitulli a paragrafi që ndiqet në të njëjtën radhë nga teksti. Po ashtu pas fjalës *Shënim*, kur ndiqet nga një numër që tregon rendin e shënimeve, pika vendoset pas numrit:

*Lufta e dytë e Selenicës. Ndeshja e parë e madhe me armiqtë...
Shënim. Po ta kthejmë këtë fjali në ligjëratë të drejtë...
Shënim 3. Disa emra të përveçëm me prejardhje të huaj...*

Nuk vihet pikë pas titullit të një vepre, të një gazete, të një kreu a të një nënkreu kur ky s'ndiqet në të njëjtën radhë nga teksti:

*Gjenerali i ushtrisë së vdekur
Kur qesh tërë qyteti
Formimi i emrave*

§ 13. Nuk vihet pikë (as ndonjë tjetër shenjë pikësimi) në fund të adresave, as pas formulave të përshëndetjes, me të cilat mund të mbyllet letra:

*Dritan Dajti
Rruga «Qemal Stafa» 40
Tiranë
Me përshëndetje të përzemërta
Petriti*

§ 14. Ndiqen rregullisht me pikë (më rrallë me pikë e vizë) numrat romakë ose arabë që shënojnë radhën e një kreu, të një nënkreu a të një paragrafi ose radhën e çështjeve, të pikave të një shtjellimi, rezolute etj.:

I. Drejtshkrimi i zanoreve

5. *Organizimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe i kryengritjes së përgjithshme popullore.*

§ 117. *Format gramatikore të mënyrës dëshirore.*

1. *Koha e tashme. Format e kësaj kohe...*

Parimet që do të përcaktojnë përfshirjen e një fjale në «Fjalor» duhet të jenë:

1. *Përdorimi i qëndrueshëm i fjalës në letërsinë e sotme...*

2. *Përdorimi i qëndrueshëm i fjalëve në veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit...*

§ 15. Vihet pikë në datat e plota, pas numrit që shënon ditën dhe radhën e muajit, po nuk vihet pikë pas numrit që shënon vitin:

19.2.1978 ose 19.II.1978

Shënim. Kur muaji shënohet me emrin e tij, nuk ndahet nga dita e viti as me pikë, as me ndonjë shenjë tjetër pikësimi:

20 nëntor 1978

§ 16. Ndahet me pikë numri që shënon minutat, nga ai që shënon orët, kur në mes tyre nuk përdoret lidhëza e:

ora 12.35

§ 17. Pika përdoret si shenjë grafike edhe në disa shkurtime:

a) të emrave të personave, pas shkronjës a shkronjave të para:

F. Noli (Fan Noli), A. Z. Çajupi (Andon Zako Çajupi) etj.;

b) të fjalëve që shënojnë titull, gradë, profesion, pas shkronjave të para:

agr. (agronom), *akad.* (akademik), *dr.* (doktor) *prof.* (profesor) *kol.* (kolonel), *sh.* (shoku) etj.;

c) të disa fjalëve të tjera, pas shkronjës a shkronjave të para ose pas shkronjave të para të rrokjeve të ndryshme, në fjalorë, vepra shkencore etj.:

bot. (botanikë), *fr.* (frëngjisht), *gr.* ose *greq.* (greqisht), *it.* ose *ital.* (italisht), *kap.* (kapitull), *mb.* (mbiemër), *khs.* (krahaso), *mjek.* (mjekësi), *f.* ose *fq.* (faqe), *sh.* (shih), *p.sh.* (për shembull), *b.f.* (bie fjala), *d.v.* (dora vetë), *etj.* (e të tjera).

Por nuk përdoret pika:

a) në shkurtimet e emrave të njëjive të masave:

cm (centimetër), *km* (kilometër) *a* (amper), *dgr* (dekagram), *kg* (kilogram), *hl* (hektolitër), *l* (lek ose litër), *t* (ton), *v* (volt) etj.;

b) në simbolet e elementeve kimike:

Cl (klor), *H* (hidrogjen), *Mg* (magnezium) etj.;

c) në shkurtimet e emrave të pikave të horizontit:

L (lindje), *P* (përdim), *VL* (verilindje), *JP* (jugpërdim);

ç) në shkurtimet e emërtimeve të përbëra që shënojnë shtete, organizata, institucione, ndërmarrje etj.:

RPSSH (Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë), *PPSH* (Partia e Punës e Shqipërisë), *BRPSH* (Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë), *ATSH* (Agjencia Telegrafike Shqiptare), *UP* (Ushtria Popullore), *NTLAI* (ndërmarrje tregtare lokale e artikujve industrialë), *SMT* (stacion i makinave dhe i traktorëve), *OKB* (Organizata e Kombeve të Bashkuara) etj.

PIKËPYETJA (?)

Pikëpyetja shënon përfundimin e një fjalie a të një periudhe që shqiptohet me intonacion pyetës.

§ 18. Pikëpyetja përdoret në fund të një fjalie pyetëse të drejtë, si edhe në fund të një periudhe me fjali pyetëse të bashkuara me lidhëza bashkërenditëse ose pa lidhëza:

Nga vini, ore trima? — pyeti plaku që rrinte në një shkëmb pranë rrugës.

Të kem fjetur me gjithë mend?

Dalim tani? — tha vëllai.

Në brigadë shkon?

A s'erdha unë pas pak dhe t'i dhashë?

Mos vallë qe shembur kasollja, kishte zënë plakun brenda dhe e kishte gjymtuar?

Pikëpyetja vihet edhe pas përemrash e ndajfoljesh pyetëse, po ashtu edhe pas pjesëzash pyetëse ose pjesëzash të tjera që përdoren si fjali pyetëse:

Ku? Kur? — pyetën përnjëherësh të dy shokët.


Me kë? — pyeta unë.

E? — pyeti ai me padurim.

Po?

§ 19. Kur vijnë njëra pas tjetrës disa fjali të mëvetëshme a periudha pyetëse të ndryshme, pikëpyetja vihet si rregull pas secilës prej tyre:

Si the? Kush është ajo vajzë? E bija e kujt është? Nga është? Ku punon? Sa vjeç është? Kur ka ardhur këtu? Si e quajnë?



§ 20. Kur ka një pyetje të shumëfishtë, me fjali ose me gjymtyrë të njëjta të bashkuara me lidhëzën veçuese apo ose ndonjë lidhëz tjetër si kjo, pikëpyetja vihet në fund të periudhës a të fjalisë:

*I ke të dhëna të sigurta apo flet në erë?
A është më mirë apo më keq?*

Por vihet pikëpyetja pas secilës fjali pyetëse ose pas secilës gjymtyrë të njëjtë kur kërkohet të theksohet ajo e të dalë më e shkëputur nga fjalia a gjymtyra tjetër, si diçka e shtuar:

*Po Petriti a do të ketë ndryshuar gjatë këtyre viteve? Apo do të jetë po ai i pari: i urtë, i sjellshëm, i dashur?
Do të vish të martën? Apo të enjten?*

§ 21. Kur një pyetje (e pjesshme) me fjalë pyetëse ndiqet nga një pyetje pa fjalë të tilla, pikëpyetja si rregull vihet pas secilës prej tyre:

*Ç'të bënte? Të ikte?
Cili dru është më i fortë? Dushku?
E, baba, si u ngryste? Mirë?
Vallë cilin kishte qarë ajo? Të birin? Të vëllanë? Të nipin?
Po kë të ndiqte? Natën? Zguret? Përrenjtë dhe prroskat?*

Më rrallë, në të tilla raste fjalia a gjymtyra e njëjtë pyetëse e dytë nuk ndahet me pikëpyetje, po me presje për t'i paraqitur pyetjet e njëpasnjëshme si një tërësi e vetme:

*Kush foli, Bimi? — pyeti ai.
Ç'mbledhje kemi, të rinisë?*

§ 22. Po ashtu vihet pikëpyetja në fund të një periudhe me fjali të varura prej një fjalie ose disa fjalish kryesore pyetëse që e ruajnë intonacionin pyetës deri në fund:

*Ti ç'u the kur dëgjove të flitnin kështu?
Po a e di, more shok, se raste të tilla nuk të vijnë shpesh?*

§ 23. Vihet pikëpyetja në fund të një periudhe që mbaron me një fjali pyetëse:

*Ai është zverdhur në fytyrë, nuk e shikon?
Më vinte keq për të, po ç'të bëja?*

*Kam një hall të madh, do të më ndihmosh?
Hë, filloni, ç'pritni?*

§ 24. Pikëpyetja përdoret edhe pas një fjalie a periudhe të ndërkalur pyetëse që është vendosur brenda kllapash:

Do t'i tepronte ndonjë lek nga pazari i këmborëve dhe (ku ta dish?) blinte edhe qelepocen, edhe xhamadanin, edhe kutinë.

Gjer para se ta zinte gjumi (ose, e pati zënë gjumi?), ai nuk i kishte dhënë asnjë përgjigje të prerë asaj pyetjeje.

Shënim. Nuk vihet pikëpyetja pas një fjalie a periudhe pyetëse të ndërkalur të vënë midis dy vizash.

§ 25. Në ligjëratën e drejtë nuk vihet pikëpyetje, po dy pikat në fund të fjalisë a të periudhës pyetëse që shpreh fjalët e autorit, kur vjen para fjalëve që riprodhohen:

A të kujtohen fjalët e tij: «Le t'i djegin shtëpitë, ne do t'i bëjmë më të bukura kur të çlirojmë Shqipërinë!»

§ 26. Në dialog pikëpyetja mund të përdoret në vend të fjalëve të një bashkëbiseduesi për të dhënë qëndrimin pritës a pyetës të tij kur ai s'ka të qartë diçka:

— Më tërhoqi vëmendjen fizionomia e tij, — tha Memoja.

— ?

— Fizionomia.

— Ç'është kjo fizionomi — pyeti Rrapoja.

Lamtumirë, Fan, s'dihet në shihemi më!

— ?

— Lamtumirë, Fan, mos u dëshpëro!

§ 27. Vihet pikëpyetje në fund të titujve të veprave letrare, shkencore, të të përkohshmeve, të gazetave, të kapitujve etj. që janë fjali pyetëse:

Gazeta «Ku vemi?» ishte një ndër organet demokratike të viteve 1923-1924.

Shikojmë shfaqjen e estradës profesioniste të Durrësit «Kush e do fjalën?» dhe bëjmë pyetjen...

§ 28. Pikëpyetja, e vënë në kllapa, përdoret për të shprehur dyshimin, rezervën ndaj thënies së mëpërparme ose për të shprehur dyshimin për vërtetësinë a saktësinë e fjalës pranë së cilës shkruhet. Kjo ndodh sidomos kur referohen

mendimet a fjalët e një tjetri ose kur citohet prej një vepre ndonjë copë, paragraf, periudhë, fjali a pjesë e tyre:

Tani ne kemi, më në fund, një orvatje për ta formuluar në mënyrë të saktë dhe zyrtarisht taktikën iskriste në rezolucionin e «Konferencës kushtetuese (?) të Jugut» të menshevikëve (Lenin).

Shënim. Në botime shkencore, kur riprodhohen dokumente historike ose tekste në bazë të një origjinali dorëshkrim, ndiqet me pikëpyetje në kllapa thënia ose fjala, leximi i së cilës ka qenë i vështirë dhe është i dyshimtë, i pasigurt riprodhimi i dhënë; po ashtu kur, sipas botuesit, nuk është i drejtë, i saktë formulimi ose fjala që është në origjinal:

Në vendet ku kanë vënë këmbën këta sundues... kanë ndodhur fatkeqësi të atilla, saqë, nëpërmjet kufijve tërë lëvizje (?) sa e sa të mjerë dhe të dëshpëruar, sa e sa nëna e fëmijë kanë humbur jetën nëpër përrën timer për t'i shpëtuar shpatës së armikut. (Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, T. 1978).

§ 29. Përdoret pikëpyetja në vend të një date të panjohur ose pas një date të pasigurt:

Pjetër Bogdani (? — 1689) është ndër të parët që krijoi disa terma shkencore.

Konstandin Kristoforidhi (1827? — 1895) bëri një punë të madhe e serioze në shekullin e kaluar për studimin e gjuhës shqipe dhe për përpunimin e gjuhës sonë letrare.

§ 30. Në dialog, për të vënë në dukje karakterin e theksuar pyetës të një fjalie, mund të përdoren ndonjëherë edhe dy ose më shumë (zakonisht gjer në tri) pikëpyetje të shkruara njëra njera pas tjetrës:

Në mbjelljen e misrit Unëëë???

§ 31. Pas fjalive të mëvetësishme dhe periudhave pyetëse të quajtura «retorike» (me të cilat nuk pyetet realisht për diçka, po vetëm shprehet me forcë të veçantë një pohim a mohim), vihet zakonisht një pikëpyetje e ndjekur nga një pikëçuditje, ashtu si në fjalitë pyetëse thirrmore. Ndonjëherë përdoret vetëm pikëpyetja, dhe kjo kur kërkohet të mos vihet në dukje karakteri thirrмор, kur në shqiptimin e fjalisë a të periudhës ndihet më shumë intonacioni pyetës:

E ku merr vesh ti nga jeta?!

Kush e mëson tërë atë tekst që i ka vënë autori në gojë?!

Mirëpo kush i zë besë fjalës së tij?

E si të mos jetë aq i dashur ky vend?

PIKËÇUDITJA (!)

Pikëçuditja shënon përfundimin e një fjalie të mëvetësishme a të një periudhe që shqiptohet me intonacion thirrmore.

§ 32. Pikëçuditja vihet në fund të një fjalie dëftore-thirrmore a të një periudhe me fjali të tilla:

Po sa kujtime të ëmbla e të bukura ia pushtuan mendjen e zemrën atë çast sekretarit!

Më paske bërë një të mirë! — foli ai i kënaqur.

Ehu, e paskan zënë mendimet Dinin!

Ndonjëherë Rrapoja nxehej: — «S'kuptoni gjë fare nga taktika? Pykë jeni!»

Ç'fushë e bukur!

Sonte, më në fund, edhe unë do të ngre një doli dhe do të pi një gotë!

§ 33. Vihet pikëçuditje në fund të një fjalie dëshirore-thirrmore e nxitëse-thirrmore, si edhe në fund të një periudhe me fjali të tilla:

Rroftë Partia e lavdishme e Punës, organizatorja dhe udhëheqësja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Të gjithë do të thonë: «I lumtë pushka!»

Dalçi faqebardhë!

Qofshi me shëndet e mirupafshim!

Ah, kur s'erdhe një gjysmë ore më parë!

Asnjë të mos luajë nga vendi! — urdhëroi Skënderbeu.

Nisuni, djem, shpejt! — thirri me sa zë kishte.

Shokë! Lidhuni për dore, mos i lini të kalojnë!

Të shkosh dhe të marrësh një makinë! — i tha Teuta Petritit.

Doktor Besimi lëshoi çantën dhe thirri: Ujë! Ujë të valuar! Një legen me ujë të valuar!

Mos! — i tha me zë të ulët.

§ 34. Vihet pikëçuditje në fund të një periudhe me nënrenditje që ka si fjali kryesore një fjali me karakter thirr-mor qoftë ajo dëftore, dëshirore ose nxitëse.

Le të mobilizohemi me të gjitha forcat, shokë dhe shoqe, për të përvetësuar marksizëm-leninizmin, ideologjinë e Partisë sonë, e cila ndrit me shkëlqim dhe na tregon rrugën e komunizmit, rrugën e lumturisë! (E. Hoxha).

Sa mirë bëtë që trokitët në derën time! — tha Petriti.
Të lumshin këmbët që na urdhërove në shtëpi!

§ 35. Vihet pikëçuditje në fund të një periudhe që mbaron me një fjali me karakter thirr-mor:

Ajo është e fortë, që rroftë sa malet!

§ 36. Në fund të një fjalie të mëvetësishme pyetëse retorike, të një fjalie tjetër pyetëse thirrmore e të një periudhe të përbërë prej fjalish të tilla të bashkuara pa lidhëza a me lidhëza bashkërenditëse pas pikëpyetjes vihet edhe një pikëçuditje (sh. edhe § 31):

E ku mund të mbajë ajo një valixhe?! — tha ai me zë.
Po ku humbët kështu, more djem?! — i qortoi gjyshja.
Vallë, asnjëra s'kishte dalë për ta parë?! As e ëma?! As Lavdia?!
Edhe ti je zemëruar me mua?! — e pyeti ai me çudi, duke vënë buzën në gaz.

Si?! — thirri ajo duke ngritur përsëri fshesën. Ti babai i Gjeraqinës?!

Ne flemë gojëmyllur... — A?!

Kush e njohu dhe nuk u mahnit nga mendjemprehtësia dhe njohuritë e tij të gjera?!

Përdoret ky pikësim edhe në fund të një periudhe që ka si fjali kryesore një fjali pyetëse retorike a një fjali tjetër pyetëse thirrmore.

E ku ka gjë më të lartë se të vdesësh për lirinë?!

Si nuk na u dha të ngushëllonim Mitin?!

Shënim. Për të vënë në dukje më shumë karakterin thirr-mor të fjalisë a të periudhës pyetëse, përdoret ndonjëherë pikëçuditja e ndjekur nga pikëpyetja:

Dhe ai më thotë, i habitur: «Pse e ndaluar është!? Nuk e dimë.»

Po kështu?! Ç'është nevoja që shoku Agim të lërë punët që ka, dhe të paraqitet në takim!?

Po ti ç'më rri shtrirë ashtu!? Ngreu, se s'të shoh dot.

Kur karakteri thirrмор është mjaft i theksuar, zotërues, përdoret vetëm pikëçuditja; ky është pikësimi më i dendur.

Oh, moj Zare! Ku të shkon mendja!

Pupu, moj bijë, si flet kështu!

Kush s'u çudit!

Ku nuk shkeli këmba e tij!

E kush matet me rininë, që çan rrugë të reja dhe të vjetrën shemb!

§ 37. Vihet gjithnjë pikëçuditje pas një thirrori ose një pasthirrme të përdorur më vete, shpeshherë edhe pas një thirrori a pasthirrme në krye të një fjalie të mëvetësishme a të një periudhe, kur dalin disi të shkëputura prej saj për t'u vënë në dukje më shumë, për t'u theksuar më shumë:

a) Dikush thirri: *Lumtë! Lumtë!*

Bobo! — thamë ne.

Tyt! — shfryu plaka.

b) *Komandantë, komisarë dhe partizanë!* Detyrat që kemi përpara, janë të mëdha...

Teftë! Të kujtohet ç'më the natën e parë që erdhe në fshat?

Heu! I paskemi rënë shkurt fare!

Shënim. Pasthirrmat e përsëritura mund të marrin në fund pikëçuditje e të ndahen nga njëra-tjetra me presje ose mund të vihet pikëçuditja pas secilës pasthirrme për ta theksuar më shumë atë:

Ej, ej, ej! — ia bëri kryetari me qesëndi.

Uf, uf! Ç'të flas unë e gjora!

Ahaha! Ahaha! I zumë.

Bre! Bre! Bre! — habitej një fshatar i kaluar nga mosha.

§ 38. Vihet pikëçuditja edhe pas një onomatopeje që përdoret më vete:

Gaaa! — buçiti amfiteatri.

Pam! Pam! Pam! — ushtoi arma e tij

Ha-ha-ha! — qeshi ai me të madhe.

Era vërtitej dhe ulërinte: — *Vuu! Vuuu!*

Kuh-kuh! — u kollit plaka.

Onomatopeja shoqërohet me pikëçuditje edhe kur është në fund të fjalisë a të periudhës, po jo kur është në mes të saj:

Kënga e qyqes kumbonte kobshëm lugjeve: kuku, kuku!

U mata ta qëlloja, po pësht ia bëri dhe mori buzën e përroit.

S'di si i rrëshqiti këmba e bëlldumb brenda në det.
Çupëzat qeshën hu-hu-hu dhe u turpëruan.
Sa merrja veten, bam një gjë tjetër.

§ 39. Vihet pikëçuditje në fund të një fjale (a të disa fjalëve), të një fjalie a të një periudhe të ndërkalur me karakter thirrmos të vënë në kllapa:

Të më falin shokët (dhe shoqet, domosdo!) që po e nis me të tilla fjalë bisedën.

Në atë dhomë unë pashë dy shtretër (po ç'krevate e ç'shtresa!), të cilët zinin tërë dhomën.

Dua t'ju flas me përshtypjet e një plakut, siç jam unë (plak nga mosha, por i ri nga zemra, të kuptohemi!), për një nga veprat e mëdha të këtij pesëvjeçari.

Ajo (e djegtlë zjarri!) na paska pasur një pasqyrë që i shikonte të gjitha.

§ 40. Në dialog mund të përdoret pikëçuditja në vend të fjalëve të një bashkëbiseduesi për të dhënë çudinë a një ndjenjë tjetër të shprehur me anë të mimikës; në raste të tilla mund të përdoret ajo edhe e shoqëruar me pikëpyetje për të shprehur njëkohësisht si qëndrimin pyetës, ashtu dhe ndonjë ndjenjë:

— Eja të shkojmë.

— Ku?

— Atje!

— ...!

— Te i plagosuri.

— Si, si the? Pa përsërite edhe një herë.

— Le të qëllojë i pari ai që s'ka asnjë të metë.

— ?!

§ 41. Pikëçuditja, ndonjëherë pikëpyetja e shoqëruar nga pikëçuditja, më rrallë pikëçuditja e ndjekur nga pikëpyetja, e vendosur në kllapa, përdoret për të shfaqur dyshimin për vërtetësinë e thënies a për saktësinë e fjalës pranë së cilës vihet, ironinë dhe mosmiratimin; kurse në citimet për të vënë në dukje karakterin e gabuar të një mendimi a të një mënyre të shprehuri (në këtë rastin e fundit mund të përdoret edhe fjala latine *sic!* «posi!» e shoqëruar me pikëçuditje):

Ata ktheheshin në Shqipëri si «ajka e nacionalizmit shqiptar» dhe, pavarësisht se merrnin rroga të majme nga pushtuesit dhe ki-

shin hyrë në shërbim të plotë të tij, mbanin lidhje me ata elementë «antifashistë e antizogistë» të cilët mendonin se këta emigrantë të kthyer nga jashtë ishin politikisht si 13 vjet më parë (!).

Ky autor e ngre lart guximin e «bashkatdhetarit energjik» të tij për këtë udhëtim që e kishte ndërmarrë «duke vënë kokën në torbë» (?!).

Vetëm në ndikimin e formalizmit mund të shkruheshin të tillë përrenj fjalësh pa kuptim, të lejohej një zhvlehtësim, inflacion i tillë i fjalës. Letërsisë sonë, — thotë një kritik, — i mungon gnoseologjia dhe elementi akseologjik (!?).

Përfaqësuesi i Anglisë kërkoi që kjo masë të përkrahej me një tjetër, me nisjen e një kontingjenti prej 500 ushtarësh, nga trupat ndërkombëtare të ndodhura në Shkodër, «që do të delnin në Tiranë për t'i prerë Esatit rrugën e arratisjes nëpër mal» (sic!).

Komisioni vështronte shtëpinë... Në oxhak digjeshin kërcypë (!) lisi. Dy kandila tymosnin varur në mur.

§ 42. Për të vënë në dukje karakterin thirrmos të theksuar të një fjalie a të një periudhe, mund të përdoren edhe dy ose më shumë pikëçuditje:

Hima vuri buzën në gaz me hidhërim duke thënë me vete: Ah, sikur të ndodhte kështu!! Sikur të ishte e vërtetë!!

Ç'komedi!!

Mosmarrëveshje të vogla ekzistojnë!!!

Pikëçuditja mund të përdoret e përsëritur edhe në kllapa për të shfaqur mosmiratim, ironi etj. ndaj një thënieje.

«Vendet e anëtarëve të këshillave të mbikëqyrjes, — shkruan Jeidels — ua japin vullnetarisht njerëzve me emër të dëgjuar, si edhe ish-funksionarëve të shtetit që mund të lehtësojnë mjaft (!!) marrëdhëniet me autoritetet».

Shënim. Në të tilla raste, ndonjëherë pikëçuditja nuk vendoset në kllapa:

Kur panë pushtuesit nazistë se nuk e shkatërruan dot Frontin Nacionalçlirimtar, kërkuan marrëveshje për armëpushim!! UNÇI nuk duhej të godiste gjermanët, por mund të luftonte «Ballin», zogistët dhe kë të donte!!

PRESJA (.)

Presja ndan ose veçon gjymtyrë të një fjalie ose fjali të një periudhe. Presja i përgjigjet një pushimi të shkurtër në ligjërimin e folur.

Përdorimi i presjes në fjali

§ 43. Presja përdoret për të ndarë gjymtyrë homogjene (p.sh.: kryefjalë, kallëzues, kundrina, përcaktorë etj.) që bashkohen pa lidhëza. Kufijtë midis gjymtyrëve të tilla, të cilat mund të jenë edhe të zgjeruara me gjymtyrë të tjera, në ligjërimin e folur dallohen me pushime të shkurtra:

Çdo vijë e fytyrës, çdo lëvizje e dorës, çdo fjalë, çdo hap i Skënderbeut tregonte njeriun e veprave të mëdha.

Ai foli **për zakonet arbëreshe, për vallet, për këngët popullore, për luftën e fisit të tij, për qëndresën mbinjerëzore të shqiptarëve.**

Përpara teje është skena e madhe, e gjerë si fusha me lule, ku populli **me fyej, gajde, opinga, xhoke, lëvizje, zëra, mimikë** po derdh një copë të shpirtit të tij.

Mikpritja është një nga zakonet **më të lashta, më bujare, më njerëzore** të popullit tonë.

Shënime 1. Në fund të vargut të gjymtyrëve homogjene që ndodhet në fillim ose në mes të fjalisë, nuk vihet presje:

Asnjë presion, asnjë shantazh e bllokadë, asnjë intrigë e komplot nuk e ka shmangur e nuk do ta shmangë as edhe një grimë Partinë tonë nga vija e saj revolucionare.

Por do të vihet presje në fund të vargut të gjymtyrëve homogjene, në qoftë se para këtij vargu ka një përemër a ndajfolje me kuptim përgjithësues:

Cilitdo: nxënësve, pedagogëve, popullit, punëtorëve, fshatarëve, të madhit e të voglit, Partia duhet t'u mësojë me të gjitha mjetet dhe format, në radhë të parë, marksizëm-leninizmin, shkencën që u ndriçon rrugën të gjitha shkencave (E. Hoxha).

2. Vihet presje edhe para një përemri a ndajfoljeje me kuptim për-

gjithësues që vjen pas vargut të gjymtyrëve homogjene, sidomos kur gjymtyrët homogjene nuk janë të zgjeruara me fjali përcaktore (shih edhe § 133):

Dy selvi të larta përtej, një fole e madhe lejleku majë një plepi të vetmuar, mullarët si çadra të verdha, horizonti i mbuluar me mjegull të bardhë, të gjitha këto duken sikur përsëriten vazhdimisht.

Sa për taktikën e Skënderbeut, pritat, befasitë, mashtrimet, këto gjithnjë kanë qenë elemente të luftërave.

3. Nuk ndahen me presje përcaktorët johomogjenë që shprehen me mbiemra. (Në këto raste përcaktori i dytë nuk lidhet drejtpërdrejt me emrin, po me tërë togun *emër+përcaktor* dhe midis dy përcaktorëve nuk mund të shtohet lidhëza *e ose dhe*):

Cilësitë e saj *të larta morale-politike* rinia po i tregon dhe sot me punën e saj vetëmohuese për ndërtimin socialist dhe për mbrojtjen e vendit (E. Hoxha).

§ 44. Vihet presje para fjalëve *si, p.sh., si p.sh.* kur paralajmërojnë numërimin dhe ndiqen nga një varg gjymtyrësh homogjene:

Stacioni është si një njeri që e thërresin me epitete të ndryshme, *si: kuqo, bardho, kuqal, balash,* dhe asnjeri nuk ia di emrin e vërtetë.

Kuptimi i foljes së prejardhur zakonisht nuk largohet shumë nga ai i temës fjalëformuese, *p.sh.: përcaktoj, përçap, përdredh* etj.

§ 45. Ndahen me presje gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëzën kundërshtore *po (por)* dhe me lidhëzën këpujore *as*:

E tanishmja nuk e përgatit të ardhmen *nëpërmjet ëndërrimeve dhe imagjinatës, po nëpërmjet parashikimeve* shkencore.

E keqja njeriut nuk i vjen nga *urtësia, por nga mendjemadhësia.*

Të plagosurit nuk donin të vdisnin *shtrirë, as më gjunjë.*

Sytë e tij të ndezur nuk shikonin *xixëllimën* e yjeve të rralla, *as shkëlqimin* e hirtë të hënës së prerë.

§ 46. Gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëzat këpujore *e, dhe, edhe,* përgjithësisht nuk ndahen me presje:

Oshëtima e lumit na shoqëron *në çdo bisedë e në çdo hap.*

Ai asnjëherë s'kishte menduar *për jetën e tij dhe për pavdekësinë.*

Në raste të veçanta, para lidhëzave *dhe, edhe* të përdorura me kuptim shtesor vihet presje:

Të mbjellat janë të mbara, **edhe** bagëtia.

§ 47. Ndahen me presje gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëzat këpujore *si edhe, si dhe, ashtu si edhe*:

Figura e tij *tek unë, si edhe te shumë moshatarë* të mitë u shndërrua pak nga pak në një simbol.

Përparime të rëndësishme u shënuan në *zhvillimin e arsimit e të kulturës, si edhe në mbrojtjen e shëndetit* të popullit.

Po përhapej legjenda se ai ishte i paprekshëm *nga mundimet* trupore, **ashtu si edhe nga armët** e armikut.

Shënim. Nuk vihet presje para shkurtimit *etj. (e të tjera)*, që mbyll vargun e gjymtyrëve homogjene:

Në një sallë të vogël, të ndriçuar bukur janë ekspozuar prodhime të ndryshme të kombinatit: *basmë, dok, kabardinë, puplin, fill etj.*

§ 48. Gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëzat veçuese *ose, o, apo, a* nuk ndahen me presje:

Ai mbajti një fjalim para ushtrisë dhe tha se *liria ose vdekja* në skllavëri varej nga lufta që do të bënin kundër të huajit.

Vetëm më të rrallë dëgjohej ndonjë zhurmë që shkaktohej nga zhytja e *kredharakëve, bajzave ose vidrave* dhe që përzihej me zërin e *zogëzave të ujit ose të ndonjë rose a rosaku* të plagosur.

Është apo s'është për fuqitë e tua, këtë e di seksioni që të ka urdhëruar.

S'dinim ç'të bënim: *të hynim apo të mos hynim* në qytet.

Po, kur lidhëza veçuese *ose* ndiqet nga pjesëza *edhe*, para saj vihet presje:

Atje do të shkosh ti, ose edhe ndonjë tjetër që i njeh mirë ato anë.

Rruga ishte plot rreziqe, sepse mund të takoheshim me *patrullat armike, ose edhe me ndonjë autobлиндë* që vente e vinte në xhade.

§ 49. Ndahen me presje gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëza të përsëritura: *edhe..., edhe...; dhe..., dhe...; as..., as...; si..., si...; ose..., ose...; o..., o...; qoftë..., qoftë...; herë..., herë... etj.*

Ai foli me ta *edhe për kohën e mirë, edhe për mbjelljet e kryera, edhe për dëborën e parë, edhe për duhanin.*

Kjo çështje duhet biseduar shtruar **dhe me punëtorët, dhe me specialistët.**

As në sjelljen, as në fytyrën, as në fjalët e tij nuk vërehehin shenja tronditjeje.

Si nga numri, si nga artileria kjo ushtri nuk ishte më e vogël se ajo që rrethoi e mori Kostandinopojën tre vjet më vonë.

Ato ditë Jorgji Borën e gjeje ose në brigadën e shtatë, ose majë qerreve, ose në traktorin e Mihalit, ose hipur në kalë, ose në këmbë nëpër llucë e ujëra.

(Se ç'plagë më është hapur këtu, ju e kuptoni, more mik, — dhe i tregoi anën e zemrës.) — *Po o ne, o ata.*

Qoftë fatkeqësia, qoftë lumturia, kur vijnë papandehur, të tronditin njësoj.

Unë e ime motër shikonim herë babanë, herë nënën.

§ 50. Ndahen me presje gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëzat dyshe *jo vetëm...*, *por edhe...*; *si...*, *ashtu (edhe)...*; *sa...*, *aq edhe...* etj.:

Partia *jo vetëm teorikisht, po edhe praktikisht* e edukon klasën punëtore të ndërhyjë e të thotë fjalën e fundit kurdoherë (E. Hoxha).

Më pas do të shihte se ajo paskësh qenë *jo vetëm një betejë e madhe, po edhe një fitore e shkëlqyer.*

I pa me sy të gjitha dhe i qau njësoj si *vëllanë, ashtu edhe partizanin.*

Ju bëni një punë sa të *dobishme, aq edhe të vështirë.*

§ 51. Ndahen me presje fjalët e përsëritura në të njëjtën formë, të bashkuara pa lidhëza, kur secila formë ruan mëvetësinë, pra kur nuk formojnë një shprehje me kuptim të vetëm:

Qyteti shtrihej në tërë gjatësinë e fushës dhe syri s'të zinte *veçse shtëpi, shtëpi, shtëpi.*

Jam lodhur e dua të *fle, të fle...*

Dhe të gjithë së bashku, njerëzit toka dhe qielli, *akuzonin, akuzonin, akuzonin.*

Larg, shumë larg puna që bëja nga ëndrrat që thurja.

Jo, jo! Kjo nuk është e udhës.

Oj, oj! Po ma bën qejfin.

Shënim. Format e përsëritura të fjalëve që formojnë një shprehje (ndajfoljore, pasthirmore etj.), bashkohen me vizë lidhëse:

Ai shkoi me hap të ngadaltë deri te tavolina e mori shkresën dhe e bëri *copa-copa.*

Shumë-shumë ai mund të tërhiqet përkohësisht, po jo të dorëzohet.

Ajo ishte e shqetësuar, se herë pas here thoshte: «*Ba-ba-ba!* Unë të rri këtu!»

§ 52. Ndahet me presje dhe një formë e përsëritur e një fjale kur prihet nga pjesëza për:

Për e mirë, e mirë është

Për vonë, vonë ka shkuar.

Për burrë, burrë është, s'i trembet syri hiç.

§ 53. Presja përdoret për të veçuar gjymtyrë të ndryshme të fjalisë (përcaktorë, ndajshtime, rrethanorë, kundrina me parafjalë, përcaktorë kallëzuesorë) për shkak të nuancave kuptimore që fitojnë, për shkak të zgjerimit, të rendit jo të zakonshëm të tyre ose për shkaqe thjesht stilistike. Në ligjërimin e folur pushimet e shkurtra dhe ulja e tonit i veçojnë këto gjymtyrë nga pjesa tjetër e fjalisë për t'i vënë më shumë në dukje. Gjymtyrë të tilla ndahen me presje kur janë në fillim e në fund të fjalisë, vihen midis presjes kur janë në mes të saj:

1) përcaktorë të veçuar:

I mbështjellë me fluturat e mëdha e të bardha të borës, ai kishte diçka prej përmendoreje.

Skënderbeu, **i lajmëruar prej Vranakontit**, la në kufi një ushtri prej 4000 vetësh.

Ky popull, **i sulmuar shumë herë në befasi**, e ka të mprehtë ndjenjën e përgjimit.

Ai, **i thithur nga hijet e të fshehtat e pyllit**, po hynte gjithnjë e më thellë.

Mbi shtyllën e lartë, **ngritur me blloqe gurësh cilindrikë**, digjej ylli i mbrëmjes.

2) ndajshtime të veçuara:

Moisiu, **mjeshtër i ardhshëm i pritave**, nuk e harroi kurrë mësimin e asaj dite.

Flladi i lehtë, **fllad dehës vjeshte**, lëvrinte mbi zallishtë si një puhizë jetëdhënëse

Qytetin e ri e kanë pagëzuar me emrin e njeriut më të shquar të këtyre anëve, **plakut të maleve, dragoit të Dragobisë, Bajram Currit**.

Tashti mbetet përpara një rrezik tjetër, **rreziku i vendasve**, që vërtiteshin aty-këtu me pushkë në krah.

Shënim. Ndajshtimi që lidhet me një përemër vetor, ndahet zakonisht me presje:

Ai i bluante të gjitha përbrenda dhe me *ne*, shokët e tij të ngushtë, nuk guxonte të hapej.

Unë përfytyrova se si kishte ardhur *ai*, i huaji, pas gjurmëve të mia.

Po, kur përemri vetor dhe ndajshtimi shqiptohen të lidhur, pa pushim në mes tyre, dhe me një mëshim më të madh te ndajshtimi, nuk ndahen me presje:

E dëgjoni? Po flet për *ne* vashat.

S'do të dëgjoni dot këngën e bilbilave dhe të thëllëzave, që e keni aq qejf *ju* qytetarët.

3) rrethana të veçuar:

Tej, nga **perëndimi**, mbi kurorën e pishës së vetmuar po varej dielli.

Jashtë tendës, në dritën e trazuar dhe në ajrin e hollë, bëhej një farë/loje e jetës dhe e vdekjes.

Që kur lindi Gjoni, **tre vjet më parë**, njollat e verdha ishin fiksuar në fytyrën e saj.

Dy ditë më vonë, në një kohë me erë e me shi, ne filluam përsëri marshimin.

Ajri dridhej ngadalë, si një rrjetë e hollë, e ndritshme, e endur me *filigran*.

Armiku, pas **goditjes me artileri e aviacion**, sulmoi nga e majta.

Këto gazeta, nga **përdorimi i tepërt**, u roniteshin njerëzve nëpër duar.

Ai s'dëgjoi të shtrohej në spital, me gjithë këshillat e mjekut e lutjet e komisarit.

4) kundrina të veçuara:

Disa ditë më vonë, **bashkë me dy shokë të tjerë**, ai erdhi në fshatin tonë.

Përveç punës sime si mësues, më duhej të kryeja edhe shumë punë të tjera në ndihmë të fshatit.

5) përcaktorë kallëzuesorë të veçuar:

Më tutje dukej bregu dhe prapa tij, i lartë e **madhështor**, ngrihej mali.

§ 54. Format e pashtjelluara, ose edhe ndërtimet me forma të pashtjelluara që lidhen me foljen,

— ndahen me presje kur ndodhen në fillim të fjalisë:

Për të përjetësuar këtë ngjarje, këtu u ngrit një lapidar.

Për të ngrënë, nuk hëngri, as **për të pirë**, nuk piu, po, **për t'u**

gëzuar, u gëzua fort kur pa që të rinj e pleq hidhnin valle me shami në dorë.

Duke qenë natyrë ëndërruese, inxhinieri nisi të përfytyronte që tani se si do të bëhej kjo minierë pas pak vjetësh.

Duke dëgjuar zhurmën e butë e të pamposhtur të detit, për disa çaste ai humbi ndjenjën e kohës.

Pa e ndërprerë vrullin, u lëshua drejt bregut të detit, ku s'dukej këmbë njeriu.

Me të rënë në fund të fshatit, çau përmes një pylli me dushk e humbi nga sytë.

— vihen midis presjesh kur ndodhen në mes të fjalisë, sidomos para kallëzuesit:

Kishte ardhur atë ditë, **për të punuar nja dy orë**, edhe kryetari.

Po socializmi, **duke zhdukur shfrytëzimin**, krijoi mundësi që jeta e njeriut të jetë më e lumtur.

Dhe, **pa pritur përgjigje**, mori rrugën e vilës.

Çupës, **me të parë djalin atje në prag të derës**, iu çel fytyra.

§ 55. Forma e përcjellores dhe forma e pashtjelluar mohore, si edhe ndërtimet me këto forma, kur vijnë në fund të fjalisë, ndahen me presje:

1) kur janë homogjene me gjymtyrë të tjera, me të cilat bashkohen pa lidhëza (midis tyre mund të shtohet lidhëza e ose dhe):

«I marri!» — belbëzoi me vete **gjithë gaz e qejf, pa harruar** që farën e marrosjes ia pati shtënë ajo.

Ç'pata për të thënë, i thashë, — u përgjegj ai me **një fije zëri, pa e vështruar në sy**.

Me orë të tëra u zvarritën **pa thënë asnjë fjalë, duke e mbajtur njëri-tjetrin me rripat e belit**.

2) kur vijnë pas një rrethanori ose fjalie të nënrenditur mënyrore dhe i saktësojnë; në rast se ndërtimet me forma të pashtjellura ndodhen në mes të fjalisë, vihet presje edhe në fund të tyre:

Djali qëndroi **si qiri** para tij, **pa lëvizur as këmbë, as duar**.

Vajza u ul **ashtu si u ngrit, pa vënë re vështrimin e të vëllait**.

Kështu, duke u zvarritur me mitraloz e kaseta në krahë, dy partizanët u vërvitën tërë natën.

3) kur veçohen për t'i vënë në dukje më shumë ose për arsye të tjera; ndërtime të tilla nuk janë të lidhura ngushtë me kallëzuesin dhe para tyre bëhet një pushim i shkurtër:

Asimi, edhe pasi u lirua nga burgu fashist, nuk reshti së luftuari për idealin e tij, **duke folur e duke shkruar.**

Kur shkoi të nesërmen makina për të korrur tërfil, hunjtë ia çapëluan thikat, **duke e lënë batall në mes të çairit.**

Atë natë dhe të nesërmen ndenja në Fier me Adilin e me shumë të rinj fierakë, **duke pritur të na jepnin armë e të na dërgonin në Vlorë.**

Ne mbetëm te stanet, **pa ditur ç'të bënim e ku do të vinim.**

Doktor Besimi lëshoi një të qeshur, **pa e çarë kokën për ata që ecnin rrugës, të mbledhur e të mpirë nga të ftohtët.**

Forma e paskajores dhe forma e pashtjelluar mohore, si edhe ndërtimet me to nuk ndahen me presje kur lidhen ngushtë me kallëzuesin:

Pastaj ujku u ngjiti kodrave përpjetë **duke ulërirë me një zë të çjerrë, që të kallte datën.**

Babanë e gjeti me sqepar në dorë **duke rregulluar grazhdet.**

Po hajde t'i mbaje partizanët në atë tërbim që po i shkumëzonte, tërbim që s'kishte për t'u dalë **pa ia marrë hakun shokut.**

Duheshin peshuar mirë rrethanat e të veprohej **pa u bërë vonë.**

§ 56. Ndërtimet me paskajore dhe ndërtimet me formën e pashtjelluar të tipit *me të ardhur*, kur vijnë në fund të fjalisë, nuk ndahen me presje:

Pasi bënte apelin, ngrinte kokën **për t'u hedhur një sy të shpejtë nxënësve.**

Pse i qeshte fytyra **me të ngjitur këto shkallë?**

Ndërtimet me paskajore të prira nga lidhëza *si* ose pjesëza *sa* ndahen me presje kur veçohen për t'u vënë më shumë në dukje:

Në stallë gjëja e gjallë lëvizte e shqetësuar, **si për të përshëndetur agimin e ri.**

Do të marr vetëm një kokërr, **sa për të bërë me shëndet.**

§ 57. Ndërtimet me paskajore, ose edhe një paskajore e vetme në funksionin e një përcaktori nuk ndahen me presje;

nuk vihet presje as në fund të tyre, në qoftë se ndodhen në mes të fjalisë:

Aty u vu në dukje entuziazmi e shpirti revolucionar i rinisë shqiptare, gatishmëria e saj për të përballuar çdo therori.

Lufta e popullit tonë për të mbrojtur tërësinë tokësore ka qenë e gjatë dhe heroike.

§ 58. Thirrori që hyn në përbërjen e një fjalie, ndahet me presje kur ndodhet në fillim a në fund të fjalisë; vihet në mes presjesh kur ndodhet në mes të saj (shih edhe § 37):

O mina, mina, ju gjëmoni, / Shpërthe, **o tym i zi!** / Dhe ti buçit, **o këng' e punës,** / Fuqishëm në malësi.

Po kështu do të vihet presje pas fjalëve që shënojnë personin a sendin të cilit i drejtohem (formulat e mirë-sjelljes), në letra etj.

Të dashur shokë,

Po marr penën t'ju shkruaj...

§ 59. Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme ndahen me presje kur ndodhen në fillim a në fund të fjalisë; vihen midis presjesh kur ndodhen në mes të saj:

Me një fjalë, Gëzimi kërkon që njerëzit edhe dhjetë ose njëzet vjet të shkuar të vepronin ashu siç e kërkon koha sot.

Sidoqoftë, ty të shkon më shumë fjala.

Bile, ishin të bindur për këtë që po bënin.

Me të vërtetë, ashtu si kishte ndryshuar ai, nuk mund të njihej.

Dhe atëherë, **si për çudi,** më lindi dëshira të shkruaja edhe unë poezi.

Unë, **për veten time,** ja ku po jua them copë se s'do të kisha guxim as t'i dilja në sy krushkut.

Dhe kishte ca arsye, **sipas mendjes sime,** që të vepronte kështu.

§ 60. Fjalitë e ndërmjetme ndahen me presje kur ndodhen në fillim a në fund të fjalisë; vihen midis presjesh kur ndodhen në mes të saj:

Me sa më kujtohet, ti ke qenë me ta atë ditë.

Unë, **të them të drejtën,** kisha dëshirë të rrija me të.

Dhe, **ç'është e vërteta**, asnjë njeri në fshat nuk dinte gjë për këtë fejesë.

Mua më vinte keq, **ç'është e drejta**.

§ 61. Pjesëzat *po*, *jo* kur ndiqen nga një fjali që zbërthen përmbajtjen e tyre, ose kur pjesëza *jo* ndjek një fjali për të përforcuar mohimin, ndahen me presje:

Po, fjalët në këto raste janë të tepërta.

Jo, ajo s'kishte ndërmend të ndahej nga *kjo bukuri e rrallë e nga ky ajër i pastër*.

Nuk do të kthehem, jo, — përsëriti me vete djali.

Mund të ndahen me presje edhe disa pjesëza të tjera kur kanë të bëjnë me fjalinë në tërësi e shqiptohen disi të veçuara për t'u theksuar:

Dhe ja, ai po bënte shërbimin e parë në jetën e tij.

Zuri ngoje dhe fatin e saj, pale!

Shënim. Kur pjesëzat i takojnë një gjymtyre të fjalisë, ato shqiptohen të lidhura, pa ndonjë pushim midis tyre, dhe në ligjërimin e shkruar nuk ndahen me presje:

Ja cila ishte ëndrra ime në atë kohë.

Këto janë thënë, **po jo të gjithë** i kemi parasysh.

Veçanërisht *kjo fjalë* i bëri gjyshit një përshtypje të madhe.

Shqisat dhe mendja jonë janë në alarm **sidomos në net të tilla.**

Pikërisht ai u sul i pari.

§ 62. Pasthirrmat që hyjnë në përbërjen e një fjalie, ndahen me presje kur ndodhen në fillim e në fund të saj; vihen midis presjesh kur ndodhen në mes të fjalisë (shih edhe § 37):

Oh, sa kohë kisha pa e dëgjuar atë këngë!

Eu, po për mua e keni therur atë ftujak?

Oi, kaq e lodhur paske ardhur, moj nuse?

Qyaja, ç'bëra unë kështu, **qyaja!**

Kanunet, **he**, kanunet dhe zakonet e vjetra do t'i zhdukim.

§ 63. Në shkresa, letra, relacione, botime etj. presja përdoret për të ndarë emrin e vendit ku shkruhet ose botohet diçka, nga data ose nga viti kur është shkruar a botuar:

Tiranë, 28.8.1970

Tiranë, 1978

§ 64. Në citime e në bibliografi presja përdoret:

1) për të ndarë emrin e autorit, titullin e veprës a të artikullit, titullin e revistës ku është botuar, numrin e revistës, vitin e botimit të saj dhe faqen:

Agim Dajti, Dita e madhe, «Nëntori», Nr. 10, 197..., f. 50.

2) për të ndarë llogarin nga emri kur llogari vihet para emrit:

Dajti, A.: Dita e madhe, «Nëntori», Nr. 10, 197...,

Përdorimi i presjes në periudhë

§ 65. Ndahen me presje fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat e përsëritura *edhe... , edhe... ; hem... , hem... ; as... , as... ; o... , o... ; ose... , ose... ; ja... , ja... ; herë... , herë... :*

Dhe kali ishte goditur, / dhe kordha ishte thyer, / dhe vetë ishte drobitur, / dhe mburoja ishte shqyer.

Është bërë një punë e madhe: hem kulla e beut u dogj, hem bereqetin beu s'e mori dot.

As pushkë s'po dëgjoheshin, as flakë nuk po shiheshin.

Ferdinandit s'i mbetej veçse njëra nga të tria: a ta linte fortësën dhe të ikte nga ana e detit, a të sulej kundër ushtrive armike, a të jepej i gjallë në duar të tyre.

Atëherë në fushë bëhej një nga të dyja: ose shtrëngonte acari i akullt, ose vërshonin nga malet valët e shkumëzuara.

Ja e njoh unë doktorin, ja s'e njeh njeri.

Herë digjej një depo, herë vritej një spiun, herë asgjësohej një repart i tërë me alpinë ose bersalierë.

§ 66. Ndahen me presje fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat dyshe *jo vetëm... , por edhe... ; le që... , por, edhe... :*

Nga kjo jo vetëm u fituan shumë sipërfaqe të reja toke, por u krijuan edhe kushte shumë të favorshme për rritjen e rendimenteve.

Le dhelpra që i shpëtoi, por humbi edhe çarkun.

§ 67. Me presje ndahen fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat kundërshtore *po (por), kurse, ndërsa, veçse, veç, vetëm se:*

Partia jonë ishte shumë e re, por megjithatë ajo s'bëri kurrë aventurë (E. Hoxha).

Guri pëlçet, po njeriu s'pëlçet.

Në mbrëmje e zinte gjumi vonë, kurse në mëngjes i dilte shpejt.

Dyshemeja ishte shtruar me pllaka ngjyrë hiri, ndërsa muret ishin lyer me ngjyrë bizele të hapët.

Plaka as e ktheu kokën nga ai, veçse zemra iu lëndua nga ato fjalë.

Edhe pemë kishte mbjellë djali, vetëm se pemët ishin ende të vogla e nuk ta mbushnin syrin.

§ 68. Ndahen me presje fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat përmbyllëse *prandaj, andaj, ndaj*:

Rruga dhe programi i Partisë ishin shpresat dhe aspiratat e popullit, **prandaj** Partinë e ndoqi populli.

Njërit do t'i kalojmë fare pranë, **andaj** bëji sytë katër.

Ajo është e vajzë qyteti, **ndaj** e habiste natyra e ashpër e këtyre maleve.

§ 69. Ndahen me presje fjalitë e bashkërenditura me lidhëzën *pa*:

Më janë rënduar këmbët, **pa** do të vija edhe unë me ju, — u tha plaku të rinjve.

Të vinte me ne në autobus, **pa** të sosnim edhe në mesnatë!

§ 70. Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat këpujore e, dhe, edhe zakonisht nuk ndahen me presje:

Tisi i hirtë i pyllit u zhvendos e u shtri qetësisht mbi rrëpi-rat e zhveshura.

Qëndroi vetëm një çast buzë lumit dhe vështroi përtej bregut të lartë rreshtin e errët të rrapishteve.

Në orën katër pasdite kështjella prapsi sulmin e tretë dhe topat e armikut gjëmuan për hakmarrje.

Gruri kishte mbirë edhe arat bleronin si në prill.

Ndahen me presje fjalitë e bashkërenditura këpujore:

a) me nuancë rrjedhimi (sidomos kur lidhëza pasohet nga ndajfoljet *atëherë, kështu*):

Fëmijët po e dëgjonin me vëmendje, dhe gjyshja e ndiente veten të gëzuar.

Komandanti turk refuzoi, dhe atëherë Depa nisi t'arrihte fortesën me artileri.

Te Gryka e Patës punëtorëve u bie të çajnë kanalën drejt, dhe kështu ata do të gërmojnë disa kilometra më pak.

b) me nuancë kundërshtore (sidomos kur lidhëza pasohet nga fjalët *prapë, prapëseprapë, megjithatë, megjithëkëtë*):

— Të tjerët na presin me padurim e ne rrimë në vend si gurë kilometrazhi.

(Dhoma ndriqohej nga tri dritare.) Dy shikonin nga kopshti, dhe njëra nga sheshi.

Kaq herë kemi folur për rëndësinë e kritikës dhe të autokritikës, dhe prapë ai s'e hap gofën.

Mbrëmja është e ftohtë, e megjithatë ne rrimë në ballkon dhe vështrajmë qytetin.

c) me nuancë shtesore:

Jashtë era e kishte shtuar vrundullin e saj, dhe kjo kuptohej nga fërshëllima e gjatë e pa fund e telave.

Ajo luftoi për një botë të re, dhe kjo botë fitoi.

Të dy ushtritë u përleshën, dhe beteja mbajti deri në orën tre pasdreke.

Ishte i vogël atëherë, dhe kujtimet e vegjëlisë mbeten për herë të gjalla.

§ 71. 1. Fjalitë e bashkërenditura veçuese me lidhëzat ose, a nuk ndahen me presje:

Retë e bardha mund të nxiheshin papritur e të lëshonin rrebeshe vjeshte ose mund të zhdukeshin pa u vënë re.

Ai mendoi të largohej ca kohë nga qyteti ose të shtihej i sëmurë dhe të priste si do të rridhnin ngjarjet.

Do të shkonim ne atje a do të vinin ata këtu, këtë askush s'e dinte.

Ai ikte përpara si një re tymi dhe as kthente kokën ta vështronte a t'i thoshte një fjalë.

Para lidhëzës ose vihet presje kur fjalia e parë e bashkërenditur ndiqet nga fjali të tjera:

Duka kishte rënë në kurthin e lajmeve të rreme që përhapte vetë senati, ose këtë ai e dinte, po kërkonte të nxiste Skënderbeun.

Ai kishte mbetur pa forca dhe nuk ishte në gjendje të ndërmernte një aksion të vërtetë, ose po përgatiste asgjësimin e plotë të forcave turke, siç bëri me Ballaban Baderën.

2. Fjalitë e bashkërenditura veçuese me lidhëzën apo ndahen me presje:

*Të ishte me të vërtetë kaq e hijshme vasha, apo i bënin sytë!
Moj nënë, a dëgjon ti ulërima e bubullima, apo më bëjnë ve-
shët mua?*

Ajo ishte pak e shqetësuar: do ta pranonte vallë profesori me
aq vonesë, apo do ta çonte në drejtori.

§ 72. Ndahen me presje gjithë fjalitë e varura që ndo-
dhen para kryesores:

Që jeni përpjekur shumë, këtë e di, — tha plaku.

Sa kishte ecur, as ai vetë s'e dinte.

Ç'të mbjellësh, do të korrësh.

Kur lindi dielli, hymë në fshat.

Sa të rrosh, do të mësosh.

Që të mos ia prishnin qetësinë plakut, bisedonin me zë të ulët.

(— Ki besim te ne.) — Se pata besim, pa jua hapa zemrën.

Meqë ishte dimër, ne mbylleshim herët në shtëpi.

Si vajzë që isha, kisha edhe unë ëndrrat e mia.

Po s'e mbajte në dorën pushkën, ta rrëmbejnë fitoren.

Të mos ishte çelur atë vit klasa e pestë në fshatin e tyre,

Mara do të ishte tani në shkollën e Rrëshenit.

*Megjithëse një herë kam kaluar këndeje, pylli më duket si një mik
i vjetër.*

*Çfarëdo stuhish që të shpërthejnë në qiellin shqiptar, Republika
Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk tundet nga pozitat e saj.*

*Në gottë se në vitin 1938 jeta mesatare e njeriut në vendin tonë
ishte rreth 38 vjet, sot ajo ka arritur në 69 vjet.*

Sa e fortë ishte vajza, aq i dobët ishte djali.

§ 73. Fjalitë kryefjalore, kundrinore e kallëzuesore (me
lidhëzat që, se, sikur ose pa lidhëza, me përemra lidhorë a
pyetës, me ndajfolje pyetëse etj.), kur vijnë pas kryesores,
nuk ndahen me presje:

a) Dalngadalë po i kujtohej se ç'i kishte ndodhur.

Kryesorja është që nga e kaluara të mbajmë pranë forcën dhe
madhësitinë dhe të mënjanojmë errësirën.

Petritit iu duk sikur për herë të parë në jetë po vinte re
lindjen e diellit.

Nga ne kërkohet të ishim të vëmendshëm e kurdoherë gati.

Të kujtohet si ëndërronim për të ardhmen?

b) Ushtarët e rinj i kërkonin Skënderbeut me lutje e me klithma
që t'i shpinte kundër turqve.

Çdo njeri duhet të mësojë se si nxirret buka me djersën e ballit.
Të rinjtë shtruan mbi tavolina g'kishin sjellë me vete.

Nga gëzimi harroi gjithë ç'i kishte ndodhur rrugës.

Atë ditë i pyeti shokët në e kishin kaluar mirë këtë pjesë të vësh-tirë të rrugës.

c) Shqetësimet shpeshherë i dukeshin sikur ishin me vend.

Ca ditë më vonë gjyshi u bë përsëri si kishte qenë më parë,
i gëzuar e i qeshur.

§ 74. 1. Fjalitë përcaktore (me përemrat lidhorë që, i cili dhe me ndajfoljen ku etj.) ndahen me presje kur nuk janë të lidhura ngushtë me gjymtyrën e përcaktuar. Fjali të tilla shprehin një karakteristikë si një sqarim të mëtejshëm, shtesor:

Celulat, që përbëheshin përgjithësisht prej tre anëtarësh, merreshin kryesisht me përgatitjen e tyre teorike.

Fushës së gjerë vërtitëshin erëra të lagështa, që rrëzonin gjethet mbi pellgjet e turbullta.

Ne, që asnjëherë s'u ishim shmangur vështirësive, nuk ngurruam të kryenim edhe një punë të tillë.

Kjo është merita e madhe e Partisë sonë, e cila e ka mbrojtur si gjënë më të shtrenjtë marksizëm-leninizmin.

Të gjithë pritnin përfundimin e kësaj ngjarjeje të pabesuar, nga e cila mund të ndërronte fati i luftës me Turqinë.

Konferenca e Pezës ligjësoi bashkimin vullnetar të masave të gjera popullore, bazat e të cilit ishin hedhur nga poshtë në luftën kundër pushtuesve,

Ky mëngjes, në ajrin e të cilit sillej gëzimi, i zbulonte papritur diçka të harruar.

Kapërceu urën e Zaranikës, buzë së cilës ishte centrali me fabrikën e vajit.

Ali Kelmendi vendosi lidhje edhe me Grupin Komunist të Korçës, në të cilin gjendja nuk ishte e kënaqshme.

Plevica e dikurshme që ndarë në katër kthina, njëra prej të cilave ishte mjaft e madhe.

Gjoni u shkëput nga parmakët e anijes dhe u vërsul te bashi, ku dy detarë po manovronin velin.

Pastaj u kujtua se këtë ndjesi e provonte gjithnjë anës detit dhe buzë lumenjve, ku njeriu ndalet padashur, si për të kundruar rrjedhën e jetës.

2. Fjalitë përcaktore (me përemrat që, i cili, ç, sa dhe me ndajfoljet ku, nga, kur) nuk ndahen me presje kur janë të lidhura ngushtë me gjymtyrën e përcaktuar. Fjali të tilla shprehin një karakteristikë dalluese (që e dallon sendin e shprehur

nga fjala e përcaktuar), prandaj edhe janë të domosdoshme për të:

a) Ai s'kishte parë *njeri tjetër që të synonte drejt qëllimit me një ngulm të tillë.*

Ky ishte një gëzim pa shkak, ishte thjesht *gëzimi që i shkaktonte mëngjesi.*

Ata shikonin me ëndje atë *pamje industriale që hapej nga maja e kodrës.*

Dashuria, njohja dhe respekti reciprok janë *baza mbi të cilën mbështetet familja jonë socialiste.*

Ai preu *rripat me të cilët ishin lidhur kuajt në karrocë.*

Po ku kishte ditë më të madhe se *ajo që u dha bujqve tokë!*

Ne që fituam luftën me pushkë, do të fitojmë edhe luftën me kazmë.

Paçi uratën, — u tha plaku të rinjve, — *ju që merrni vesh një çikë më mirë, do të më shpjegoni dot një gjë?*

Nga e djathtapo ngrejné *diçka që ngjan si punishte për derdhjen e topave,* — i tha roja komandantit të kështjellës.

Ka zot kjo tokë. *Kushdo që e shkel, e paguan shtrenjtë.*

Të gjitha sa u thanë më sipër, tregojnë qartë rëndësinë e rritjes së rendimentit në punë.

Të tëra ç'ka kooperativa, tonat janë.

b) Ai ngriti kokën dhe hodhi sytë edhe një herë *nga shtëpia ku kishte kaluar fëmijërinë.*

Mori sahatin dhe u ul *buzë vijës nga do t'i vinte uji.*

Ishin *çastet kur ai mendohej, dhe unë nuk duhej t'ia këputja fillin e mendimeve.*

3. Fjalitë përcaktore që bashkohen me lidhëzat fthilluese që, se, nuk ndahen me presje:

Kjo ikje u dha shqiptarëve përshtypjen se *turqit nuk do të ktheheshin në Shqipëri për shumë kohë.*

Unë ngula këmbë në *propozimin tim që ai të mbetej në listë.*

4. Ndahen me presje fjalitë përcaktore që lidhen me kryesoren me përemrin *çka* ose me *gjë që*:

Me zhdukjen e pozitive ekonomike të kapitalit të huaj iu dha fund varësisë ekonomike nga fuqitë imperialiste, gjë që forcoi edhe më shumë pavarësinë ekonomike të vendit.

Rilindasit kanë dhënë një kontribut shumë të shquar për lëvrimin e shqipes së shkruar, për çka populli shqiptar i kujton përherë me mirënjohje.

§ 75. Fjalitë vendore (me lidhëzat *ku, tek, nga, kudo që, ngado që*) që vijnë pas kryesores, nuk ndahen me presje kur plotësojnë foljen ose ndajfoljet *aty, atje, këtu, andej, këtej*:

Mos e lëndo **ku i dhemb.**

Karrociери *vingëllinte* kamxhikun **nga mundte.**

Anija *shëtiste* nëpër det **nga e merrte era.**

Me atë kapelen e rrasur gjer te veshët dhe me mëngë të përveshura, atë e *gjeje kudo që vlonte puna.*

Shqiponjën me yllin e kuq i *shihje ngado që veje.*

Kompania jonë do të presë *atje ku fillon e ngushtohet përroi.*

Plaku treti vështimin *andej nga shkoi i biri.*

Fjalitë vendore ndahen me presje kur saktësojnë një rrethanor vendi:

Ullinjtë shekullorë humbitnin *tutje, ku syri nuk shikonte dot më.*
Shikonim *poshtë, ku gjeratorja hapte e mbyllte gojën e madhe.*

§ 76. Fjalitë kohore (me lidhëzat *kur, që kur, sa, derisa, sapo, para se, si, pasi, që, sa herë që etj.*), kur vijnë pas kryesores, nuk ndahen me presje:

Unë i kam parë **kur punonin të varur me litar majë digës, në hidrocentral.**

Pastaj ne të vegjlit pritnim pranë vatrës **gjersa prushi të mbulohej me hi.**

Burri pa edhe një herë me vëmendje **para se të hidhte hapin e fundit.**

Rrihe hekurin **sa është i nxehtë.**

Vjeshta e verdhë po shkonte dalngadalë **pasi u kishte dhuruar njerëzve gjithë të mirat.**

Lumi dilte nga shtrati **sa herë që binte shi thellë në male.**

Ndahen me presje fjalitë kohore:

1) që saktësojnë një rrethanor kohe:

Ai duhej të priste të paktën *nja katër a pesë orë, derisa të kthehej plaku.*

Gjithçka do të ishte gati *pasdite, para se të binte çanga.*

Aksionistët u lanë lamtumirën maleve *pas një muaji, si hapën njëmbëdhjetë hektarë tokë të re.*

Karvani u nis *herët, sapo kishte lindur dielli.*

Ne u kthyem në kamp *në mbrëmje vonë, kur cipa e zezë e natës kishte mbuluar çdo gjë.*

2) me *kur* të anasjelltë:

Petriti s'kishte bërë as dhjetë hapa në kopshtin e shtëpisë, **kur një qen nisi të lehte pas tij.**

Po dilnim nga pylli, **kur dëgjuam një fishkëllimë të mprehtë.**

3) me lidhëzat *derisa, gjersa* me nuancë rrjedhimi:

Atje tej të thirrurat e Qamilit u rralluan, u bënë të pafuqishme, **derisa në bodrum u bë heshtje e zakonshme.**

§ 77. Fjalitë mënyrore (me lidhëzat *si, sikur, siç, ashtu si (siç), në mënyrë që*) ndahen me presje kur nuk lidhen ngushtë me fjalinë kryesore dhe nuk vijnë fill pas kallëzuesit të saj:

Pas vetëtimës shiu ia dha edhe me shumë, **si të kishte marrë zemër.**

Në mes të natës buçiti një krismë e fortë, **sikur të kishte shkrepur rrufeja mbi kullë.**

Kënga e popullit ka lindur pas çdo rrebeshi, **ashtu siç shfaqet ylberi pas furtunës.**

Ata filluan të rrokulliseshin në lëndinë, **siç bënë në vegjëli.**

Kur saktësojnë një rrethanor mënyre, fjalitë mënyrore ndahen me presje, edhe sikur të vijnë fill pas kallëzuesit:

Melodia u shtrua *ngadalë*, **si të binte shi mbi një çati kashte.**

Edhe ai *me vrull* u ngrit, **si t'i kishte ardhur befaz një mendim. Ashtu do të shkojnë, si kanë ardhur.**

Fjalitë mënyrore nuk ndahen me presje kur lidhen ngushtë me kallëzuesin e fjalisë kryesore e vijnë fill pas tij:

Të bëhet *siç thotë Partia.*

Zemra i rrihte **sikur donte t'i delte nga gjoksi.**

Bëra **ashtu siç më tha plaku.**

— Mos më thëncin Agim, po s'u bë **kështu si them unë!**

§ 78. Fjalitë qëllimore (me lidhëzat *që, me qëllim që*) ndahen me presje kur nuk janë të lidhura ngushtë me kryesoren:

Luftoni paragjykimet prapanike të së kaluarës, **që të mos vuajnë vajzat dhe mbesat tuaja, djemtë dhe nipërit tuaj.**

Duhet të shkrihem në punë, **që këta kalamaj dhe gjithë kalamajtë e botës të mos e njohin mjerimin.**

Përpara, **që ta dërmojmë një herë e përgjithmonë fashizmin.**

Komunistët shqiptarë zhvilluan një propagandë të gjerë anti-fashiste, **me qëllim që të krijonin një lëvizje popullore.**

Fjalitë qëllimore nuk ndahen me presje kur janë të lidhura ngushtë me kallëzuesin e fjalisë kryesore, sidomos kur vijnë fill pas tij dhe nuk kanë në krye lidhëz:

Të dy kishin ardhur atë ditë të takoheshin me shtabin partizan të asaj zone.

Plakū u mundua ta mbante veten.

Një qerre rropatej të dilte nga balta.

Gori jepte e merrte t'u mbushte mendjen.

Ai rendi të përqafonte gjyshin.

§ 79. Fjalitë shkakore (me lidhëzat *se, sepse, meqenëse, për shkak se, për arsye se, që, meqë, ngaqë* etj.), kur vijnë pas kryesores, përgjithësisht ndahen me presje:

Ne s'e peshuam jetën, sepse zëri i atdheut ishte busulla më e sigurt për çdo mëmëdhetar.

Vetëm armiqtë nuk i bashkon me ne kjo udhë, se ata kanë të tjera qëllime.

— Prit, se s'e kam mbaruar fjalën.

Ky hidrocentral nuk do të ketë ndryshim prodhimi nga dimri në verë, për shkak se rezervuari i tij do jetë shumë i madh.

Era bëhej edhe më e bezdisshme, ngaqë ndërronte drejtim papritur.

Të gjitha këto kryengritje dështuan njëra pas tjetrës, nga shkakū që shqiptarët ishin të përçarë.

Ecja nuk ishte aq e vështirë, mbasi borën e kishin çarë më përpara të tjerë njerëz.

Fjalitë shkakore nuk ndahen me presje kur janë të lidhura ngushtë me kryesoren, sidomos kur theksohen:

Bashkimi i popullit tonë në Frontin Demokratik është një gjë reale edhe për arsye se ai ka tradita lufte, pune dhe organizimi (E. Hoxha).

Ajo rrinte në shtëpinë e tij vetëm e vetëm sepse kishte miqësi me të motrën.

Kryetari e mbronte pikërisht pse ky ishte shumë i rregullt në llogari.

(E ke djalë, pa e lëvdon.) — E lëvdoj se është tamam burrë.

Dhe kjo ndodhi sepse hëpërhë ky njeri iu duk më i afërt se të tjerët.

Kryeinxhinieri u kënaq që u dha udhë gjithë atyre problemeve.

— Gëzohem që ju shoh shëndoshë e mirë.

§ 80. 1. Fjalitë rrjedhimore me lidhëzat *aq sa e kështu* që ndahen gjithnjë me presje:

Shirat e rrëmbyeshëm i mbushën lumenjtë plot e përplot, aq sa kaluan shtretërit e tyre e morën rrugë të reja.

I nipi kishte ndryshuar shumë, aq sa plaku mezi e njohu.

Hënë nuk kishte, kështu që njerëzit korrnin me fenerë.

2. Fjalitë rrjedhimore me lidhëzat *sa e saqë* përgjithësisht ndahen me presje:

Ishte një zagushi e madhe, sa të zihej fryma.

Po lumturia ishte aq e papritur, aq tronditëse, saqë e kishte zbuluar brengën diku thellë.

Era ishte aq e lehtë, saqë fletët e pemëve mezi lëviznin.

Fjali të tilla nuk ndahen me presje kur plotësojnë foljen -kallëzues të fjalisë kryesore ose kur vijnë fill pas ndajfoljeve *gjer atje, deri atje*:

Kafsha, e goditur për vdekje, ulëriti një herë sa u tund gjithë pylli.

Për tri javë u tret sa mezi mbahej në këmbë.

Puna vajti *gjer atje* sa u mblodhën gjithë shokët që ta bindnin.

§ 81. Fjalitë krahasore (me lidhëzat *sa (ç'), se, sesa, se ç', nga sa, nga ç'*) nuk ndahen me presje kur kanë lidhje me një mbiemër a ndajfolje në shkallën krahasore dhe vijnë fill pas tij ose kur lidhen me kallëzuesin e fjalisë kryesore:

Ishte një buzëqeshje aq e dëlirë sa ç'ishte i dëlirë agimi në maja.

Puna nuk ishte aq e ngatërruar sa iu duk në fillim.

Mos u mërzitni, djema! Çdo gjë do të na shkojë më mirë nga sa na ka shkuar deri sot.

Veshja e re do ta tregonte më të ri se ç'ishte në të vërtetë.

S'ka gjë më të bukur se të shikosh qindra krahë të zgjatur drejt njëri-tjetrit.

Miqtë i dua sa më duan.

Ndahen me presje kur lidhen me një mbiemër a ndajfolje në shkallën krahasore, po nuk vijnë fill pas tyre:

Ai kurrë nuk kishte folur aq shtruar me komisionin, sa ç'liste atë mbrëmje.

Kjo përgjigje më shumë e gëzoi, sesa e habiti.

Më mirë të të dalë syri, se të të dalë nami.

§ 82. Fjalitë kushtore (me lidhëzat *në, po, nëse, në qoftë se, në rast se, sikur, kur, po qe se, me kusht që* etj.), kur vijnë pas kryesores, përgjithësisht ndahen me presje:

Batalioni do të mbetet i rrethuar, **po ta merrte armiku atë grykë.**
Komunistët e rinj shqiptarë nuk do të plotësonin dot me nder detyrat e tyre të rënda në situatat e ndërlikuara, **po qe se nuk do të përvetësonin mësimet marksiste-leniniste.**

Ndoshta, nuk do të shkonte më kurrë në atë vend, **sikur atë ditë të mos kishte ngjarë diçka e jashtëzakonshme.**

Po ti a më dëgjon të të them një fjalë, **në je me të vërtetë bijë e këtij vendi?**

Nuk ndahen me presje kur janë të lidhura shumë ngushtë me kryesoren, sidomos kur theksohen:

Partia është e fortë **kur janë të forta organizatat-bazë.**

Do të vij me ju vetëm në rast se pranoni të kthehemi përsëri **bashkë.**

§ 83. Fjalja lejore (me lidhëzat *megjithëse, ndonëse, sadoqë, sidoqë, edhe pse* etj.; me ndajfoljet *sado, sido, kudo, ngado, kurdo*; me përemrat *kushdo, cilido, çfarëdo*), kur ndodhet pas kryesores, ndahet me presje:

Majat e maleve zbardhnin ende nga bora, **megjithëse ditët e fundit kishte fryrë një erë e ngrohtë.**

Askush nga ne nuk u tërhoq, **ndonëse rruga është e gjatë dhe me rreziqe të shumta.**

S'kishte asnjë dyshim për suksesin, **sadoqë çdo gjë ishte ende në letër.**

Duhet parë realiteti në sy, **sado i hidhur qoftë.**

Ndërgjegjes nuk i fshihesh dot, **kudo që të futesh.**

Ne do të vimë atje në kohën e duhur, **çfarëdo që të ndodhë.**

Unë do të dal menjëherë, **edhe në qofsha e sëmurë.**

§ 84. Ndahen me presje, kur vijnë pas kryesores, fjalitë e varura me lidhëzat *përveçqë, në vend që, d.m.th. (dome-thënë)*:

Dhe gjatë atyre dy-tre vjetëve unë mërzita botën të tërë, **përveç — që rashë dhe nga shëndeti.**

Më duket sikur po më ngushëllon ajo mua, **në vend që ta ngushëlloj unë atë.**

Në rast se i sëmuri nuk e duron si duhet kurën, **d.m.th, ka shqetësime të ndryshme, duhet të konsultohet me mjekun.**

§ 85. Fjalja e varur që futet në mes të fjalisë kryesore, vihet midis presjesh:

Veprat e artit dhe të kulturës botërore, **sado të përsosura qofshin**, nuk mund të vlejné në tërësinë e tyre si model për çdo kohë. Në qytetet dhe në krahinat e pushtuara, **ndonëse kishte mbetur një numër i vogël komunistësh**, puna e partisë nuk u kufizua.

Këta filiza, **në qoftë se ne do të kujdesemi për ta**, pas njëzet-dyzet vjetësh do ta mbushin vendin me drurë të lartë e të drejtë.

Gryka gjëmonte, **kur frynte erë**, me një zhurmë të mbytur e të thellë.

Ai, **që të mos i prishte gjumin së motrës**, eci në majë të gishtërinjve.

Ai, **si të mos kishte ndodhur gjë**, mori rrugën për në fshat.

Drita, **veçqë u mësonte vajzave zanat**, u tregonte edhe histori të bukura.

§ 86. Fjalitë e varura që përcaktojnë ose saktësojnë një gjymtyrë të fjalisë kryesore (të shprehur me emër, përemër a ndajfolje), kur janë në mes të fjalisë kryesore, ndahen në fund me presje. Në fillim të tyre presja mund të vihet ose jo sipas rasteve të përshkruara më lart në § 74, 75, 76, 77.

Juga, që kishte fryrë gjithë natën, pushoi përnjëherësh nga mëngjesi.

Më tej, ku fillonin plepat e gjatë, uji kullohej si qelibar.

Në darkë, kur hyra në dhomë, e gjeta mikun te vatra.

E vetmja rrugë që u mbetej, ishte Qafa e Kërrabës.

Edhe pyetjes së Emirës **se ku ishte shkaku i këtij dobësimi**, ai i ishte shmangur.

Ajo që ngjau në Krujë, u përsërit në Dibër e kudo në principatën e Kastriotëve.

Aty ku rruga ndahej më dysh, ai vështroi në dritën e elektrikut orën e xhepit.

§ 87. Fjalja e varur që hyn në mes të një fjalie të bashkërenditur ose të varur (më saktë në mes të lidhëzës a përemrit lidhor dhe pjesës tjetër të fjalisë), vihet midis presjes.

Plaku u bë merak, *por, kur dëgjoi në kopsht zërin e djemve, zemra iu lehtësua*.

Mjeku dukej i qetë, *por, sa më shumë i afrohej spitalit, aq më tepër i rrihte zemra*.

Treni ecte fare ngadalë dhe, kur ndaloi si i varur ndërmjet dy skajeve të natës, daullja u dëgjua fare mirë.

Ju them pa mburrje që, sa kam rrojtur, kam pasur gjithnjë këtë mall për atdheun dhe këtë dashuri për lirinë.

Ngjarjet atë dimër ishin aq të pakta, saqë, kur ndodhte diçka, njerëzit merreshin me të ditë të tëra.

Aq të kapitur ishin ushtarët nga kjo betejë qenërishte, sa, që të mblidhnin veten, qëndruan dy ditë në fushën e Torviollit.

Lumta as që e vuri re Petritin i cili, pasi zbriti nga hurma u ul pranë saj pa bërë zhurmë.

Fytyra e mësuesit është nga ato që, po i pe një herë, të mbeten në mendje.

Sytë gështenjë me një vështrim përshekues i përshtaten pamjes së tij, që, megjithëse i ka kapur të gjashtëdhjetat, shpreh ende energjinë e një të riu.

§ 88. Ndahen përgjithësisht me presje fjalitë e bashkuara pa lidhëza (për rastet që ndahen me dy pikat, shih § 102, 103, 104, 105):

Në mëngjes dielli ndriçonte sa një pasqyrë e kaltër, fletët e lagura shkëlqenin nën rrezet e diellit, kalliri me një blerim kuqërrem ngrinte kryet përpjetë.

Verës malin e përcëllon dhe e kris dielli, dimrit e pëlçet ngrica, stinëve të tjera e lajnë dhe e gërryejnë rrëketë.

Gjella me kripë, kripa me masë.

S'gjykon mosha, gjykon mendja.

Trokita nja dy herë, s'm'u përgjegj njeri.

Nuk u druhej njerëzve, përkundrazi e ndiente veten të lumtur midis tyre.

— Tani ndryshuan kohërat, do të ndryshojnë edhe ata, — e kundërshtoi plaku.

— Ne jemi njerëz të ndryshëm, nuk mund të merremi vesh, — i tha ajo.

(— A e mbylle mirë dritaren?) E mbylla, mos ki merak.

Duhet të shpejtojmë, ndryshe nuk i arrijmë dot shokët.

Perëndonte dielli, plaku e linte punën në arë; e kishte zakon të vjetër këtë.

Zure gjarpërin, shtypi kokën.

(Unë kam një çështje për të zgjidhur më përpara.) U zgjidh ajo, janë zgjidhur të gjitha.

(Unë dua të më bëhet puna, o Vasil.) Ma bën punën, të lavdëroj.

I ftoi s'i ftoi njeri, ata janë miqtë tanë

Mos ia vër re dajës: *i pirë i papirë*, ashtu flet ai.
Me prova pa prova, armiku s'kishte për ta lëshuar këtë komunist
të parë të qytetit tonë.

Ata nuk i hodhën as sytë, jo më ta përshëndetnin.

Atë s'e di as unë, jo ta dijë ai.

Në shtëpi nuk e shihte dot me sy gjellën, jo pastaj ta hante.

Shënim. Fjalët në ndërtime të tilla, si: *erdhi s'erdhi, ngrënë pa ngrënë, i pirë i papirë* etj., që shprehin alternativë të kundërt, nuk do të ndahen me presje nga njëra-tjetra:

Dhe unë, **desha s'desha**, i hipa kalit e shkova krushk.

Ishte mësuar në mal: **ngrohtë ftohtë**, gunën e mbante gjithnjë në sup.

PIKËPRESJA (;)

Pikëpresja ndan në mënyrë më të prerë se presja, po më pak të theksuar se pika fjali a togje fjalish. Ajo mund të ndajë edhe gjymtyrë të njëjta ose togje gjymtyrësh brenda një fjalie.

Pikëpresja mund të vihet për arsye sintaksore ose për arsye stilistike. Ajo ndan, në radhë të parë, fjali të gjata ose gjymtyrë shumë të zgjeruara, sidomos kur brenda tyre është përdorur presja. Është i detyrueshëm përdorimi i saj atëherë kur vënia e presjes mund të japë shkas për keqkuptime:

Nga Zona I Operative Grupi V vendosej në Dëshnicë për të mbrojtur, së bashku me Brigadën VII, drejtimin e Beratit, sidomos Qafën e Këçokut; një batalion i Grupit I vendosej në Luzat e Shtëpëz, në juglindje të Tepelenës, për të ndaluar forcat armike që mund të vinin nga Mallakastra e Vlora; batalionet e tjera të këtij Grupi mbanin Cëpon e Gjirokastrës dhe Rrëzomën e Delvinës; një batalion i Grupit IV vendosej në Peshkëpi e Nepravishtë, afër Libohovës, për të bashkëvepruar me Brigadën VIII.

Marrja e Patosit kishte rëndësi: ushtarake, sepse vihej në rrezik të drejtpërdrejtë rruga Fier-Berat, që përdorej më shumë nga pushuesit për lëvizje trupash dhe automjetesh; politike, sepse u hiqej nga duart armiqve, sidomos reaksionarëve, kjo bazë kryesore; ekonomike, sepse ndërpritej grabitja e naftës nga hitlerianët në atë rajon vajguror.

Pikëpresja mund të përdoret edhe me synime të caktuara sintaksore-stilistike për të shënuar një ndarje më të theksuar se ajo që jepet me anë të presjes, e më të dobët se ajo që jepet me anë të pikës. Në të tilla raste ajo edhe mund

të ndërkëmbëhet me presjen ose me pikën, po me efekte të tjera stilistike:

Ky program përfshinte: *shpalljen e Republikës Popullore; prishjen e të gjitha marrëveshjeve skllavëruese me Italinë fashiste; zhdukjen e monopoleve e të koncesioneve; amnistinë për të dënuarit politikë.*

Ky me katër veta u vendos kundrejt kryeportës së kështjellës; të tjerët kundrejt ledhishtave nga ana e Tiranës.

Në vend të pikëpresjes në këto dy shembulla, mund të përdoret edhe presja.

Fati i të gjitha problemeve të tjera, që kanë një rëndësi të jashtëzakonshme, varet nga organizimi dhe disiplina në punë; po nuk pati organizim dhe disiplinë në punë, nuk ka si zbatohet asnjë nga kërkesat e agroteknikës.

Dy fjalitë kryesore të plotësuara nga fjali të varura, të cilat janë ndarë këtu me pikëpresje, mund të ndahen edhe me pikë.

§ 89. Pikëpresja përdoret për të ndarë togje fjalish të përbëra prej një fjalie kryesore të ndjekur prej një ose më shumë fjalish të varura, kur bashkohen pa lidhëza ose me lidhëza bashkërenditëse (sidomos kundërshtore e përmbyllëse):

Njerëzit sa s'thyheshin në mes duke tërhequr me sa fuqi që kishin, gjithë atë hekur; thirrjet e tyre dhe krisma e qyngjeve që rrëshqitnin përmbi qyngje, të shurdhonin veshët.

Populli i thjeshtë, që donte t'i priste me plub kokës fashistët italianë, nuk kishte armë; prandaj vendosi që ato t'i gjente vetë, t'i rrëmbente, qoftë edhe me forcë.

§ 90. Pikëpresja përdoret për të ndarë fjali (a grupe fjalish) të bashkërenditura përmbyllëse e kundërshtore (irallë veçuese e këpujore) ose fjali të bashkuara pa lidhëza, kur janë mjaft të zgjeruara; po ashtu kur kërkohet të theksohen faktet e shprehura e ndarja e tyre:

Ishte trim e guximtar Rrap Guri; prandaj e donin dhe e ndëronin në gjithë Gorën.

Retë u dyndën në veri dhe rënduan mbi kurrizin e majës së Rrungajës; kurse në jug, sikur të kish dalë nga drurët e pyllit, rrëshqiti vjedhurazi një hënë e madhe.

Këshilli popullor miraton planin e buxhetit lokal; zgjedh nga gjiri i tij e shkarkon komitetin ekzekutiv dhe komitetet e këshillit; drejton, ndihmon dhe kontrollon veprimtarinë e këshillave popullore më të ulëta; nxjerr urdhëresa dhe vendime brenda kompetencave të tij.

Prona socialiste është baza e paprekshme e rendit socialist burimi i mirëqenies së popullit dhe i fuqisë së atdheut; ajo ka mbrojtje të veçantë nga shteti.

Fama e tij po rritej dita me ditë; ushtria e adhuronte; shokët e kishin zili.

§ 91. Pikëpresja është e domosdoshme për të ndarë fjali të bashkuara pa lidhëza që zberthejnë përmbajtjen e një fjale a të një togu fjalësh të fjalisë paraprirëse, nga e cila janë të ndara me dy pikat, kur brenda tyre (të paktën te njëra) është përdorur presja:

Me kapitullimin e Italisë fashiste, përpara Ushtrisë Nacional-lirimtare dëlnin këto detyra kryesore të ngutshme: të goditeshin për vdekje nazistët gjermanë në rrugë, në kazerna dhe kudo që gjendeshin; t'u bëhej thirrje njërive të reparteve të ushtrisë italiane të vëllazëroheshin me të në luftën kundër pushtuesve nazistë; ndryshe, të çarmatoseshin.

Këtë principatë Gjon Muzaka ua ndan të bijve me testament kështu: Princ Teodorit i lë krahinën e Beratit, të Kaninës, Myzeqesë dhe Skraparit; Princ Adrianit i lë Tomoricën, Oparin dhe Devollin e Madh, me Korçën dhe Sovjanin; Princ Kostandinin i lë Devollin e Vogël me Kosturin gjer në Nestram.

Shënim. Pikëpresja përdoret dendur, në akte zyrtare e në letërsinë shkencore, në shtjellime numëruese, ku rreshtohen një pas një (të shoqëruara ose jo me numra, kryeradhë ose vijueshëm) fakte të shprehura me fjali a periudha brenda të cilave mund të jetë përdorur presja (shih edhe § 8):

Këshilli i Ministrave ka këto kompetenca kryesore:

drejton veprimtarinë për realizimin e politikës së brendshme e të jashtme të shtetit;

nxjerr vendime, urdhëresa e udhëzime në bazë të kushtetutës e të ligjeve dhe për zbatimin e tyre;

drejton dhe kontrollon veprimtarinë e ministrave, të organeve të tjera qendrore të administratës shtetërore, të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore dhe cakton organizimin e tyre të brendshëm;...

Nuk dhamë hollësisht cilat ishin kushtet e këtyre paqeve veç e veç, po përgjithësisht ishin këto: 1) t'i jepte sulltanit të katër bijtë si peng të besnikërisë së tij, me zotimin nga ana e sulltanit që njëri prej këtyre do të lëshohej pas vdekjes së Gjon Kastriotit për të zënë fronin e zbrazët të principatës së Matit; 2) t'i lëshonte fortesën e Sfetigradit; 3) t'i jepte Dibrën e Poshtme dhe të Sipërmen, me ca

priviligje vetëqeverimi për vendësit; 4) të lidhte me të një aleancë, në bazë të së cilës Gjon Kastrioti të ishte i detyruar t'i dërgonte një ushtri sulltanit në çdo luftë që do të kishte me fqinjët; 5) të njihte sulltanin si kryezot dhe t'i paguante haraç.

§ 92. Pikëpresja përdoret ndonjëherë për të ndarë edhe fjali të varura të një fare të bashkuara pa lidhëza ose me lidhëza bashkërenditëse kur janë mjaft të zgjeruara ose kur kërkohet të ndahen në mënyrë më të prerë e të tërhiqet vëmendja mbi secilën prej tyre:

E panë me sy të sulet përpara i pari; të marrë pjesë në të gjitha përpjekjet si një ushtar i zakonshëm; të japë komandë për çdo lëvizje, pa e humbur gjakftohtësinë në mes të rrebeshit më të tmerruar; të manovrojë me shpejtësi e mjeshhtëri; t'i turbullojë kënd armikut duke e goditur nga fusha e betejës.

§ 93. Ndonjëherë mund të ndahen me pikëpresje nga fjalia kryesore një a disa fjali të varura (sidomos shkakore me lidhëzën *se e rrjedhimore me lidhëzën kështu që*), kur janë të gjata a të zgjeruara me fjali të tjera ose kur kërkohet të theksohen faktet e shprehura prej tyre:

Ndryshe do të derdhej gjak më kot dhe përfundimi do të ishte një robëri më e keqe se e para, dhe atëherë çdo shpresë për të nesërmen fluturonte; se një punë si kjo nisët një herë dhe, në mos vajtë mbarë, rasti dhe mjetet për ta nisur ikën e s'kthehen kurrë prapë.

Po të prodhohet më shumë, kuptohet se do të konsumohet më shumë; se në ekonominë tonë socialiste nuk ka prodhim për prodhim, pasi nuk ka konkurrencë e anarki, kështu që prodhohet vetëm ai mall që duhet t'i shërbejë plotësisht të nevojave të ekonomisë dhe të popullit.

Me këtë sjellje fitoi dashurinë e ushtarëve, aq sa kishte nderimin e tyre për fitimin e betejës; kështu që të gjithë qanin nga mallëngjimi dhe pritinin pa durim orën e shërimit, që të jepnin jetën e tyre nën flamurin e tij, sikur të ish e mundur, një mijë herë.

§ 94. Pikëpresja mund të përdoret edhe për të ndarë gjymtyrë homogjene të fjalisë, të bashkuara pa lidhëza, kur janë të zgjeruara me gjymtyrë të tjera a me fjali, sidomos kur brenda këtij zgjerimi është përdorur presja, si dhe

për të ndarë vargje gjymtyrësh homogjene që janë të lidhura më ngushtë ndërmjet tyre nga përmbajtja:

a) Në orën dy e gjysmë arritën të fundit: **Dokë Velabishti**, tetëdhjetë vjeç, prijësi i fushës së Korçës; **Bardh Gjergu prijës i Shpatit**, që rridhte nga Gjergj Golemët dhe që thuhej se kishte femijë me një zanë; **Shpend Shëndëllia**, hero popullor me tri këngë, njëra prej të cilave këndohej...


Rëndësia e këtij operacioni del: nga synimi që armiku i kishte vënë vetes për shkatërrimin e dy Brigadave të UNÇLSH (II dhe III) e të një pjesë të madhe të forcave partizane të qarkut të Elbasanit, për asgjësimin e Komandës së Shtabit të Përgjithshëm të UNÇLSH dhe për kapjen e misionit ushtarak britanik; nga pjesëmarrja e një numri të madh forcash; nga përgatitjet e gjera e të kujdesshme si për asnjë tjetër.

b) Nga Korça, në prill, u kanë shkuar partizanëve mijëra palë këpucë, këmishë, çorape e materiale të tjera veshmbathjeje; sasira të rëndësishme mielli, orizi, sheqeri, makaronash etj.; materiale farmaceutike për spitalet; shua, penj, makina qepëse e vegla të ndryshme për punëtoritë, rrobaqepësitë dhe këpucaritë; fletore, abetare, lapsa e materiale të tjera për veprimtarinë kulturore-arsimore në UNÇLSH.

§ 95. Përdoret pikëpresja në shënimet bibliografike në fund të faqes për të ndarë të dhënat për vepra autorësh të ndryshëm ose për vepra të ndryshme të një autori që përfshihen në një shënim, po ashtu në shënimet bibliografike për të ndarë të dhënat për botimet e pjesëve të një punimi në organe të ndryshme a në numra të ndryshëm të një organi ose për vëllimet e ndryshme të një vepre:

1) Shih për këtë: I.D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927, f. 40; K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, f. 73.

XHUVANI, Aleksandër: *Fjalë dhe shprehje të shqipes*, «Studime filologjike»: 1971 nr. 4, f. 193-208; 1972, nr. 1, f. 161-173; nr. 2, f. 184-196; nr. 3, f. 137-151; nr. 4, f. 157-164.



DY PIKAT (:)

Dy pikat paralajmërojnë fjalët që riprodhohen në ligjëratën e drejtë, ose numërimin, sqarimin a shpjegimin e diçkaje që është thënë në pjesën tjetër të fjalisë a të periudhës.

§ 96. Dy pikat përdoren në ligjëratën e drejtë për të ndarë fjalët e autorit nga fjalët që riprodhohen, kur fjalët e autorit prijnë:

Shoku Enver Hoxha ka thënë: «*Jo, në partinë marksiste-leniniste, në një parti luftarake proletare, nuk ka vend shturja politike dhe organizative liberale, demokracia falso.*»

Gjergj Kastrioti e nxori pallën nga milli dhe thirri: «*Për Arbërinë, o burra mbi ta!*»

U dëgjua zëri i komandantit: «*Zjarr!*»

§ 97. Dy pikat vihen para onomatopeve që riprodhojnë tinguj e zhurma të ndryshme, kur vijnë pas fjalësh që i paralajmërojnë:

Në oborr, në degët e dendura të një portokalli *ia thoshte për-vajshëm një kumri: gu-gu-gu!*

Po! Unë këndoј gjithnjë që në mëngjes e gjer në mbrëmje, këndoј tërë jetën... *Ja dëgjo: cili-cili-cilik!*

§ 98. Dy pikat vihen para një vargu gjymtyrësh homogjene kur prihen nga një emër i shoqëruar nga një numëror ose nga ndonjë fjalë tjetër që paralajmëron numërimin:

Lenini, duke pasur parasysh rendin ekonomiko-shoqëror të vendeve të ndryshme, thoshte se ekzistojnë *dy botë: socializmi dhe kapitalizmi* (E. Hoxha).

Tri ngjarje themelore shërbenjë si nyja organizuese të romanit: nxjerrja e Shqipërisë në ankand, dekompozimi i Perandorisë Osmane, shpërthimi i fuqisë patriotike popullore.

Vera shkelte ku mundte: mbi barin e njomë, mbi rrëkezat e kristalta të burimeve, mbi fletët e thata të pyjeve.

Vajza i vuri gishtin kokës dhe mendoi se misri dashka dy gjëra: tokë të punuar thellë dhe pleh.

§ 99. Dy pikat vihen pas fjalëve *p.sh., si, si p.sh. e siç janë* kur paralajmërojnë numërimin dhe ndiqen nga një varg gjymtyrësh homogjene:

Në folklor pasqyrohen me bukuri të veçantë cilësitë më të mira të popullit tonë, si: *ndjenja liridashëse, patriotizmi, dëshira për punë, besa, nderi, mikpritja, mençuria dhe përvoja e tij e pasur.*

Pas Çlirimit u krijuan qendra të reja industriale, *si p.sh.: Qyteti Stalin, Patosi, Memaliaj, Bulqiza, Cërriku.*

§ 100. Dy pikat vihen në fund të një formulimi ose rregulle, pas së cilës renditen një ose më shumë shembuj për ilustrim:

Trajtat foljore që formohen me «do të...», e ruajnë rregullisht «të-në» në shkrim: do të shkoj, do të shkoja, do të kem shkuar (dhe jo do shkoj...).

§ 101. Në referime bibliografike dy pikat vihen pas emrit të autorit kur llagapi vendoset përpara:

Shkoza, D.: *Yjet ndriçojnë*, Tiranë 1979.

§ 102. Ndahen me dy pika dy fjali të bashkuara pa li-dhëza, nga të cilat e para nuk ka kryefjalë ose kundrinë, kurse fjalia e dytë kryen funksionin e kryefjalës ose të kundrinës që mungon:

a) *Iu kujtua mirë: duhej të këshillohej me shokun.*

U bë e qartë: diçka po ndodhte atë mëngjes brenda konakëve të vjetër të Tapillarëve.

b) *Ju lajmërova me kohë: një gjë e tillë ju priste edhe ju.*

Hedh sytë andej dhe shoh: të rinjtë dhe të rejat vijnë grumbuj-grumbuj.

Përsëritim: kjo shkresë është tepër sekrete.

Ju porosit edhe një herë: mos luani nga ky pozicion.

§ 103. Me dy pika ndahen fjalitë e bashkuara pa lidhëza me marrëdhënie shtesore:

Tefta vuri re sahatin e vogël mbi tavolinë: sapo kishte kapërcyer ora shtatë.

Padashur Stefani vështroi orën: po afrohej dreka.

Mësuesi pa orën: pas njëzet minutash duhej të fillonte mësimi.

Djaloshi ngadalëson hapat e mban vesh: sëpatat bien përmbi ahe e pisha e trungjet rrokullisen me rropamë.

§ 104. Ndahen me dy pika dy fjali të bashkuara pa lidhëza, nga të cilat e dyta zberthen kuptimin e përgjithshëm e të papërcaktuar të një gjymtyre të fjalisë së parë ose gjithë fjalinë e parë:

Këtë bëmë edhe ne këtu sot: rrahëm pikëpamjet tona.

Mua më është mbushur mendja për diçka: njeriu i fortë ia del mbanë kurdoherë.

U themi mendimin tozië: grykasit të kujdesen për lokalin, pishasit për bankat.

(Lajmi i prerjes së telave të telefonit kishte marrë dheun.) Po ishte përhapur edhe një tjetër fjalë: te Zaranika na qenka bërë një përpyekje e madhe.

Shtëpia nuk ishte e keqe: ishte në qendër të qytetit, kishte dy dhoma, një kuzhinë e një podrum.

Fëmijët e bariut loznin aty pranë lodrën e ujkut dhe të qenit: ujku sulmonte kopënë, qeni dhe barinjët ia prisnin udhën dhe e ndiqnin.

I biri i kish gjithë të mirat: qe punëtor, prishanik nuk qe, vese nuk kishte.

§ 105. Dy pikat përdoren edhe për të ndarë dy fjali të bashkuara pa lidhëza kur e dyta tregon shkakun e së parës:

Duhet të bisedoj me të: s'rrihet më kështu.

Nusja e Stefanit po priste te dera: i shoqi dhe e bija ishin vonuar për drekë.

Djaloshi duhej të ishte zgjatur kohët e fundit: mëngët e xhaketës i rrinin të shkurtra.

Ç'më duhet palltoja: mjaft e kam pardësynë.

Lëreni të shkojë: dikush duhet të arrijë në Stamboll i gjallë që të lajmërojë sulltanin për fitoret tona.

Jo, më mirë shkojmë: jemi shumë vonë.

SHUMËPIKËSHI (...)

Shumëpikëshi tregon që thënia, për arsye të ndryshme, ndërpritet e nuk jepet e plotë. Ndërprerja mund të bëhet në fjali, në periudhë dhe në fjalë të veçanta.

§ 106. Shumëpikëshi përdoret për të shprehur ndërprerjen e një thënieje kur i lihet lexuesit ta marrë me mend ç'ka dashur të thotë tjetri, kur ndërhyt diçka, kur folësi ndërron mendje ose nuk e gjen dot fjalën e përshtatshme, kur ngurron ta shfaqë deri në fund mendimin etj.:

Edhe pak, — thoshte ai me vete, — edhe pak. *Sa të korrim grurin, sa të mbledhim duajt e fundit, pastaj...*

Sadoqë dëshpërohej për fatin e saj të keq, Rina kishte një shpresë të fshehtë: «*Ja, sa të më rritet djali, pa...*»

Po ti iu rrite babait, moj bijë, e do të na lësh. *Atëherë si do të bëjë babai pa...* Deshi të thoshte «pa ty», po Vita nuk e la ta mbaronte fjalën.

— E sa kohë kemi udhëtuar që kur jemi nisur nga planeti Matela?

— Tre vjet. Dhe, po të përdorim masën tuaj, kemi përshkuar një distancë prej 55 trilionë kilometra. *Tani duhet të vëzh...*

Një dritë e zbehtë u pasqyrua në ekranin e cikloskopit. Ajo e përshkoi ekranin me shpejtësinë e vetëtimës dhe u zhduk.

Hajde të folur, hajde! Ia kaloi edhe Flamurit. Deri këtu paska mbërritur ky. *Unë kujtoja se... Nejsë.*

Po, por infermieri sesi më vështronte kur m'i thoshte të gjitha këto. *Kishte një buzëqeshje, një buzëqeshje...* — ai s'e gjeti dot fjalën e duhur për ta thënë.

Po pastaj? *Ç'do të bëhet në qoftë se...*

Mevla Çelebiu nuk guxoi të thoshte «në qoftë se kalaja nuk merret».

§ 107. Shumëpikëshi përdoret në vend të një fjale a të një thënieje që s'duam ta përmendim:

Ai ktheu kokën që larg dhe thirri:

— *E di ç'bëj unë me ato kronikat tuaja të mykura? ... — këtu Siri Selimi tha dy fjalë shumë të rënda për veshin e historianit.*

§ 108. Shumëpikëshi përdoret në shkurtimet e fjalëve ose të datave që nuk duam t'i japim të plota ose që s'na kujtohen:

— Ti, shoko, s'pyetke fare për të ftohtët. Nga të kemi?

— *Nga rrethi i K...*

Aty nga fillimi i majit të vitit 197... bashkëshortët Dafa u transferuan në njërin nga sektorët e bonifikimit të qytetit.

— E morët vesh? *Fotografinë e tim biri e kanë vënë atje në mu... si i thonë...*

— Muze, — tha plaku.

§ 109. Shumëpikëshi përdoret për të shprehur mungesën ose vonesën e përgjigjes në dialog:

Ti Shqiponjë qenke?

— ...

— Eja këtu, pa eja.

Shqiponja e zbehur në fytyrë paraqitet te komandanti i çetës.

U ngrit më këmbë, nxori nga një kamare një libërth.

— ... *E sheh këtë libërth? Është fare i vogël, rëndon sa një pupël zogu, po pati një forcë aq të madhe, sa çau errësirën.*

§ 110. Shumëpikëshi përdoret në një ligjërim pa vijimësi logjike:

Gjera që ngjasin... , — tha ai duke shikuar përsëri të birin. Gjene mirë boll... Sidoqoftë, dihet... Por unë kështu them... Paçka... Ata heshtën të gjithë. Askush nuk e kuptonte se ç'donte të thoshte me ato fjalë të ngatërruara, veç të birit.

§ 111. Përdoret shumëpikëshi edhe për të shprehur pëshpërime të gjata në një të folur me ritëm të ngadaltë:

I dolën përpara si në një vegim të shpejtë sofrat e Kalcës. Të mëdha, të rënda... Të punuara trashë... Kush nuk ishte shtruar në ato sofrat... Miq, rrugëtarë, të varfër dhe pa strehë ishin shtruar përpara tyre.

§ 112. Shumëpikëshi përdoret pas një numërimi që nuk jepet deri në fund:

Ja ta zëmë sikur ta caktojme Dritën një, vëllanë e saj dy, ty tre...

§ 113. Shumëpikëshi vihet para një fjale me ngarkesë emocionale (ironi etj.) për të shprehur ndërprerjen e ligjëritimit para saj, me qëllim që të vihet më shumë në dukje:

Kaloi kjo furtunë / Një ditë e pat... / Vërtet s'bëmë punë, / Por bëmë... debat!

Dola nga klubi me premtimin se do të shkruhej patjetër për këtë eksperiencë me vlerë të... madhe.

§ 114. Shumëpikëshi përdoret në citime për të treguar që fjalia a periudha nuk jepet e plotë në fillim, në mes a në fund të saj:

«... nga një etapë në tjetrën, si çdo gjë, shkolla jonë do të pësojë ndryshime në formë, në strukturë, në përmbajtje. Vetëm një gjë nuk do të ndryshojë kurrë: shtylla e saj kurrizore, e cila do ta udhëheqë atë në çdo drejtim e në çdo transformim të saj, filozofia materialiste marksiste-leniniste.»

«Formimi i njeriut të ri... nuk mund të kuptohet dhe nuk duhet shkëputur kurrë nga çështja e punës, nuk mund të konceptohet kurrë jashtë punës.»

«Duhet të ngulim këmbë energjikisht për lartësimin ideologjik, teorik e politik të kuadrove, duke mësuar teorinë marksiste-leniniste...»

§ 115. Në ushtrimet gramatikore, aritmetike etj. shumëpikëshi përdoret në vend të një shkronje, fjale, numri a shenje aritmetike që nxënësi duhet ta gjejë:

Në vendet e lëna bosh, përdorni trajtat e shkurtra që duhen:

Në sfondin e zymtë të detit të egërsuar, kur edhe anijet e mëdha mezi... bëjnë ballë dallqëve të fuqishme, detarët tanë... ngjajnë zgalemëve që luftojnë me stuhinë.

THONJËZAT (" „ « »)

Thonjëzat tregojnë se fjalët e përfshira në to nuk janë të një natyre me pjesën tjetër të tekstit ose përdoren me një kuptim jo të zakonshëm.

§ 116. Thonjëzat përdoren në ligjëratën e drejtë dhe në citime për të veçuar e për të dalluar fjalët që riprodhohen, nga fjalët e autorit (fjalët që paralajmërojnë fjalët e riprodhuara ose që tregojnë se kujt i përkasin ato fjalë):

«Në popull ne duhet të gjejmë frymëzimin tonë, tingujt e këngës, ritmet e valles, pastërtinë e gjuhës, tempon e punës, frymëzimin e krijimit, shembullin e heroizmit dhe të sakrificës, virtytet e larta të thjeshtësisë popullore, të drejtësisë popullore etj. etj. Baza e krijimtarisë, si për çdo gjë, ashtu edhe në art e kulturë, duhet të jetë baza popullore», — ka thënë shoku Enver.

Gjysmë ore më parë dikush vraponte nëpër Rrugën Mbretërore duke thirrur si i marrë: «Qendra ra. Gjermanët po tërhiqen drejt xhadesë veriore. Qendra ra.»

Shënime 1. Thonjëzat vihen pas pikëpyetjes a pikëçuditjes kur fjalët që riprodhohen, formojnë një fjali a periudhë pyetëse a thirrmore:

«A do t'i kemi mbaruar të mbjellat para se të zënë shirat?» — Ja. kjo pyetje e shqetësonte agronomin duke iu ngjitur asaj të përpjete mali.

I panjohuri u kthye, i futi krahun dhe thirri me të madhe: «Bëhuni gardh, zihuni për krahu, që të mos na çajnë!»

2. Kur fjalët që riprodhohen, formojnë një fjali a periudhë dëftore dhe ndodhen pas fjalëve të autorit, thonjëzat vihen pas pikës:

Kujtoi kohën kur kishin punuar bashkë, dhe tha me mend: «Do të bëhej mjeshtër i mirë.»

Kur fjalët që riprodhohen, formojnë një fjali dëftore dhe ndodhen para fjalëve të autorit, pas thonjzave vihet presje dhe vizë:

«E paska radhën plaku për të dëgjuar», — *thashë me vete dhe fillova të trokitja derë më derë...*

3. Thonjëzat vihen pas shumëpikëshit, kur fjalët që riprodhohen, mbarojnë me të:

Por midis tyre kishte edhe nga ata që nuk e përmbanin dot veten dhe u thoshin shokëve: «Gati, u afruam, t'u biem...»

4. Kur fjalët e autorit ndodhen në mes të fjalëve që riprodhohen, thonjëzat vihen në fillim e në fund, në goftë se pas fjalëve të autorit nuk vihet pikë:

«Qemali që atë ditë dha të kuptohej, — tregon një nga pjesëmarrësit e mbledhjes, — se ishte shpirti dhe fytyra e rinisë sonë të gjallë dhe heroike...»

Po, në goftë se pas fjalëve të autorit vihet pikë, të dyja pjesët që formojnë fjalët e riprodhuara, vihen në mes thonjzash:

Çdo ditë ne pritnim nisjen. Më keq nga të gjithë i vinte gjyshes. Atë s'e mbante vendi. «Po si kështu, more bijtë e nënës, do të më lini vetëm?» — *na pyeste ajo me dashuri.* — «Do të mbetet e shkretë kjo bina pa ju!»

§ 117. Mbyllen në thonjëza fjalë me ngarkesë emocionale (ironi etj.) ose që janë përdorur me një kuptim të veçantë*:

Rendi kapitalist, çfarëdo ndryshimi të jashtëm që të pësojë, çfarëdo maske që të vërë, çfarëdo «teorie» që të krijojë, ai mbetet një rend shtypës e shfrytëzues.

Nëpër abetare dhe libra këndimi kishte lexuar kaq herë fjalën «Atdhe».

Operacioni i armikut u prit me një kundëroperacion më të gjerë nga ana jonë. «Termopilet» e Shqipërisë së Jugut u bënë varri i armikut.

Shënime 1. Kur një fjalë, grup fjalësh ose fjali, pjesë e një periudhe, të mbyllura në thonjëza, ndodhen në fund të fjalisë a të periudhës, shenja e pikësimit e fjalisë a e periudhës vihet pas thonjzave:

Këtu del roli i madh i teorisë revolucionare, që, siç thotë Marksi, «bëhet një forcë e madhe materiale kur pushton masat».

A e lexuat «Zërin»? — pyetëm ne pilotët që ishin grumbulluar te pista.

Në punën e Qemalit harmonizoheshin me një bukuri të pasqorë serioziteti dhe përgjegjësia që i diktonte momenti historik, entuziazmi me disiplinën revolucionare. Prandaj shokët me të drejtë i kishin vënë emrin «Rregulli».

* Në shtyp fjalët që përdoren me një kuptim të veçantë ose që kanë ngarkesë emocionale, mund të dallohen edhe me ndërrimin e karakterit të shkronjave.

2. Duhet të përdoren të dyja llojet e thonjzave, në qoftë se bie rasti të përdoren thonjzat brenda një teksti të mbyllur në thonjëza: "Megjithatë, filizat e njomë janë atje dhe ata vit për vit do të hedhin shtat e do të lartësohen. Ç'është ky budallallëk që po mendoj, sikur tani është vonë. Për të filluar një punë të mirë, s'është asnjëherë vonë. Emini po u afrohet të tridhjetave, kurse fëmijët do të thonë: «Kur ishim ne të vegjël, filloi hapja e tokave të reja.» Ja, pra, për ata është shumë herët."

§ 118. Vihen në mes thonjzash parullat etj. kur jepen pas fjalëve parullë, thirrje, porosi, lëvizje etj.:

Parulla e Partisë «Të gjithë për një dhe një për të gjithë» është bërë një normë e re e moralit socialist (E. Hoxha).

Ne kemi përqafuar të gjithë lëvizjen «Të punojmë kudo ku ka nevojë atdheu».

Në Brazil a në Argjentinë, në Republikën Domenikane a në Uruguaj dëgjohet kudo e njëjta thirrje «Poshtë imperialistët amerikanë!».

§ 119. Në thonjëza vihen, kur jepen në tekst, edhe emrat e përveçëm a togfjalëshat që emërtojnë:

a) gazeta, revista, libra, vepra muzikore:

Ulu Apostol, — e ftoi Mistoja. Ai ndenji mbi minder. Pastaj nxori nga kraharori pesë numra të gazetës «Drita» dhe dy abetare të shqipes. Teatri ynë vuri në skenë dramën «Toka jonë».

Numri i parë i revistës «Kushtrimi i lirisë», që doli në muajin gusht, iu kushtua Qemalit.

b) rrugë, bulevard, sheshe, stadione, lagje, hotele, kinema, teatro, ndërmarrje, kooperativa, uzina, kombinat, hidrocentrale, vapore, brigada, çeta, batalione, shkolla etj.:

Hidrocentrali «Drita e Partisë», kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë» dhe kombinati i autotraktorëve «Enver Hoxha» shënojnë maja të larta të arritjeve të sotme në fushën e ndërtimeve tona industriale.

E vranë një ditë trimin në rrugën «Bardhyl» të Tiranës kur po shkonte në një aksion të ri të gueriljeve.

Çeta «Tomori» qëndronte aty në pritë prej 1 korrikut, në bazë të urdhrat të shtabit të operacionit që drejtonte luftën e Përmetit.

Ne ishim shokë, kishim mbaruar *politeknikumin «7 Nëntori»* qysh më 1953.

Shënim. Emërtime të tilla, si: *Rruga e Dritës, Hoteli i Gjuetarëve* etj., që kanë në përbërjen e tyre emrat e përgjithshëm të përmendur në këtë pikë nuk vihen në thonjëza:

Kaluam nga *Rruga e Dritës*.

c) tituj, urdhra, kur vinë pas këtyre fjalëve:

Presidiumi i Kuvendit Popullor i akordoi klubit tonë urdhrin «Naim Frashëri».

Nuk ka diplomë më të mirë për një njeri, sesa titulli «Hero i Punës Socialiste».

ç) markat e cigareve, pijeve, makinave etj.:

Merr një «Tarabosh», xhaxha, është i fortë, — i deleguari i hodhi paketën.

Po gjeje «Narta» ose «Shesh i zi», merr tri-katër shishe.

Gazetari buzëqeshi, doli nga lokali dhe hipi në një autobus «Shkodra».

d) emra konvencionalë sidomos të sferës ushtarake:

Kje radiolojë njihet me emrin «Buza e bredhit».

§ 120. Në vepra shkencore vihet në thonjëza përkthimi a shpjegimi i një fjale të huaj ose përkthimi në gjuhë të huaj i një fjale shqipe:

Kështu, bie fjala, përkimet leksikore rumune-shqiptare: *briu* «brez»...

... termi «i prejardhur» është përdorur me kuptimin e frëngjishtes «*dérivé*».

KLLAPAT () []

Kllapat veçojnë fjalë, fjali a periudha që shtihen në një fjali a periudhë për të shprehur vërejtje a sqarime plotësuese. Ato shënojnë një lidhje më të dobët nga lidhja e shprehur prej vizës. Nga të dyja llojet e kllapave, kllapat e rrumbullakëta kanë përdorim të rëndomtë, kurse kllapat katrore përdoren në raste të veçanta në tekste shkencore.

I. Kllapat e rrumbullakëta

§ 121. Mbyllen në kllapa fjalë e fjali të ndërkallura që dalin më pak të lidhura me pjesën tjetër të fjalisë a të periudhës.

Dy ditë më vonë uji u lëshua dhe në fillim tubat kishin qarë (shprehje e t'et), pasta j kishin rrjedhur si më parë.

Deti, i cili atë pranverë dukej sikur ishte afruar (atëherë shquheshin gjer shkumëzimet e bardha të dallgëve dhe barkat e vogla të peshkatarëve), tani qe larguar përsëri e nuk zinte në horizont veçse një vetull gjë.

Gruda ngrihet kundër hijeve të shekujve e të pushtuesve (që marrin formën e zakoneve poshtëruese, siç është hakmarrja) dhe, pasi fiton këtë betejë në ndërgjegjen e vet, hidhet me armë në dorë kundër pushtuesve gjermanë.

Shënime 1. Kur fjala e ndërkallur ndodhet në fund të fjalisë a të periudhës, shenja e pikësimit që i takon fjalisë a periudhës, vihet pas kllapës:

Gjenerali, si zuri vend mirë, ngaqë s'kish ç'të bënte, hapi fletoren. Fleta e parë mungonte (në shumicën e ditareve që kishin gjetur, mungonin gjithmonë fletët e para).

2. Kur fjalia e ndërkallur është pyetëse ose thirrmore, në fund të saj, para kllapës, vihet shenja përkatëse e pikësimit, pikëpyetja ose pikëçuditja, dhe pas kllapës pika:

Oxhaqet, si në çdo minierë në botë, janë si arteriet e gjakut për njeriun (se vërtet, a ka, thua, minierë më të madhe se njeriu?).

Në diskutun fluturues e kalonim kohën shumë mirë. Bisedonim, flinim (oh, ç'të fjetur!).

§ 122. Kllapat veçojnë edhe treguesit skenikë në veprat teatrale. Ndërkaq këto mund të dallohen nga pjesa tjetër e tekstit edhe nga karakteri i shkronjave (kursive ose të zeza).

Jonuzi — *(Thërret.)* Mira!

Mira — *(Nga brenda)* Urdhëro baba! *(Hyn.)*

Jonuzi — Sillmë enën e ziftit këtu dhe thirrma Petritin. Shpejt! *(Mira hyn në kuzhinë dhe del bashkë me Petritin, që mban enën e ziftit.)*

§ 123. Mbyllën në kllapa fjalët që zbërthejnë një emërtim të shkurtuar ose shkurtimi i një emërtimi të plotë. Këto mund të jenë:

a) emërtime të plota të organizatave, shoqërive, institucioneve, simbole kimike, në qoftë se vijnë pas shkurtimeve dhe anasjelltas shkurtimet, në qoftë se vijnë pas emërtimeve të plota; pseudonime, në qoftë se vijnë pas emrit të vërtetë dhe anasjelltas; emërtimi i dytë i një sendi, në qoftë se përdoret krahas emërtimit të parë ose anasjelltas; shpesh edhe nëntitujt, sidomos kur dallohen nga karakteri i shkronjave:

Rastësisht dhe me rrugë shumë sekrete më kishte rënë në dorë një broshurë që ishte botuar nga *KONARE-ja* (**Komiteti Nacional Revolucionar**).

Në mars të vitit 1925 ata formuan në Vjenë organizatën demokratike me emrin «*Komiteti Nacional Revolucionar*» (**KONARE**).

Nga këto kripëra duhen përmendur: *kripa e gjellës* (NaCl), *sulfat natriumi* (Na_2SO_4), *klorur kalciumi* (CaCl_2), *klorur magnezi* (Mg_2Cl_2), *sulfat magnezi* (MgSO_4) etj.

Milosh Gjergj Nikolla (**Migjeni**), *Asdreni* (**Aleks Stavre Drenova**). *Partia Komuniste Shqiptare* (**Partia e Punës e Shqipërisë**) vlerësoi drejt në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare problemin e kalimit të pushtetit shtetëror në duart e popullit.

Një sukses i merituar
(**Shënime për operën «Komisari»**)
Dasmë pa nuse
(**Komedi**)

b) emri i një krahine a i një shteti kur vjen pas një emri gjeografik që i përket kësaj krahine a këtij shteti:

Grushtet e rënda që morën sidomos në Opar, në *Tendën e Qypit (Skrapar)*, në Tërbaç të Vlorës, u shkaktuan armiqve dëme të mëdha në njerëz dhe ua prishën planin.

c) emrat e përveçëm të huaj me drejtshkrimin e gjuhës përkatëse kur jepen krahas transkriptimit të tij në gjuhën shqipe:

Shekspir (Shakespeare), Shopen (Chopin), Balzak (Balzac)

ç) referimi i një citati kur jepet në vazhdim të tij (jo në fund të faqes), si edhe data e lindjes dhe data e vdekjes së një autori kur jepen krahas emrit:

«Por askujt gjithashtu të mos i shkojë ndër mend se, meqë Partia e Punës e Shqipërisë është e vogël, duhet të bëjë ashtu si thotë ndokush, kur ajo është e bindur se ai ndokush gabohet» (**Enver Hoxha**, «Vepra», vëll. 19, 1975, f. 394).

Naim Frashëri (1846-1900), Zef Serembe (1843-1901)

§ 124. Mund të mbyllet në kllapa edhe një pikëpyetje ose pikëçuditje, ose dhe të dyja së bashku kur përdoren për të shprehur mosbesimin, falsitetin, rezervën për vërtetësinë e asaj që është thënë më përpara (Shih § 24, 37):

Ç'kish ngjarë? «*I zoti i shtëpisë*», në rrethana të paqarta, ishte kapur nga policia fashiste dhe adresa e bazës kishte rënë në dorë të armikut (? !).

* * *

§ 125. Për të veçuar (kryesisht në nënndarje) një numër arab ose një shkronjë të vogël që tregon rendin e rasteve ose të argumenteve në një vepër shkencore, rregullore, udhëzues, kod etj., përdoret vetëm një kllapë, kllapa mbyllëse:

Nga sa u shtjellua në këtë kapitull, mund të theksohen këto përfundime të përgjithshme:

1) Në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në mjaft gjuhë të tjera indoevropiane, sistemi i rasave është thjeshtuar...

2) Si rrjedhim i thjeshtimit të lakimit të emrit, në numrin shumë të krijuar një temë e posaçme...

1. Në mënyrë të veçantë Kongresi u bën thirrje:

a) Shkollës shqiptare...

b) Institucioneve të teksteve shkollore...

c) Shkrimtarëve shqiptarë...

Kongresi shpreh besimin e tij të plotë se kjo thirrje do të përkrahet me entuziazëm...

II. Kllapat katrore

Në botimin e dokumenteve e të teksteve të vjetra kllapat katrore përdoren për të dalluar fjalët e shtuara nga botuesi i dokumentit a i tekstit nga fjalët e vetë dokumentit a të tekstit.

§ 126. Brenda kllapave katrore mund të mbyllen fjalë të shtuara nga botuesi, që e bëjnë më të qartë përmbajtjen e tekstit:

Si rezultat [i vendimeve] të Kongresit [të Berlinit] disa pjesë të Shqipërisë iu dorëzuan duarve robëruese të armiqve tanë... (Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, T. 1978).

Valiu të dërgohet na Stambolli e të urdhërohet na ministori [ministri] [i] Brendshëm (Po aty).

§ 127. Brenda kllapave katrore mbyllet emri i një vendi (qyteti etj.) që njihet e përdoret sot, i shtuar nga botuesi krahas emrit të vjetër që përdoret në dokument:

Ne të nënshkruarit, të mërguar nga kazaja e Nishit, e Leskovacit, e Urkupit [Prokuplje] dhe e Krushmlisë, me banim sot për sot në kazatë e Prizrenit, u bëjmë të ditur përfaqësuesve fuqplotë në Kongres... (Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, T. 1978).

§ 128. Mbyllen brenda kllapave katrore edhe tri pikat për të treguar që botuesi ka hequr fjalë nga dokumenti:

Kongresi zgjodhi një komision [...] për të vajtur ndë Korçë që të zgjedhin pleqësinë e shoqërisë «Përparimi» (Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, T. 1978).

VIZA (—)

Viza kryen disa funksione.

§ 129. Në dialog viza përdoret për të treguar kalimin e fjalës nga folësi te bashkëbiseduesi (shoqërohet gjithnjë me kryeradhë).

Pas një vështrimi të kujdesshëm, Agroni i tha:

— Duhet të kesh kujdes fytyrën, Dritan.

— Fytyrën do ta punoj në fund.

— Unë e kam zor me fytyrën.

— Edhe unë.

— Kë ke pasur si model?

— Babanë, minatorët që njohëm në praktikë, montatorët dhe punëtorët e hidrocentralit.

Shënim. Në qoftë se fjalët e autorit janë në mes të replikës dhe përfundojnë me pikë, atëherë në fillim të pjesës së dytë të replikës vihet vizë:

— *Sikur jemi lodhur,* — tha Landi. — **A dalim një herë?**

§ 130. Viza përdoret për të veçuar fjalët e autorit në ligjëratën e drejtë. Në këto raste, para vizës përdoret dhe presja kur fjalia është dëftore, ose pikëpyetja a pikëçuditja kur fjalia është pyetëse ose thirrmore. Kur fjalët e autorit hyjnë në mes të fjalisë, përpara vizave vihet presje:

— *Kujdes mos zgjoni fëmijët,* — u dëgjua zëri i partizanes.

— *Ku janë?* — pyeti dikush.

— *Ja tek i ke!* — ajo tregoi anën ku dukeshin tri koka të vogla fëmijësh, mbuluar me një rrobë të vetme.

«Për të njohur një send, — thotë Lenini, — duhet të kapen, të studiohen të gjitha anët e tij, të gjitha lidhjet dhe vartësitë e tij reciproke.»

§ 131. Viza përdoret për të veçuar fjalitë e ndërkallura. Ndryshe nga kllapat, që mund të përdoren në raste të tilla, vizat tregojnë një shkëputje më të vogël:

Një natë tek hanim darkë — ishte e shtunë mbrëma më duket — ai i thotë t'et:...

Në atë letër — që ishte e para pas largimit të tij nga Lezha — ai i shkruante se ishte fare mirë.

§ 132. Në fjali të mëvetësishme që përmbajnë thënie me karakter përgjithësues (proverba, parulla) e në tituj artikujsh, viza përdoret në vend të foljes-këpujë *jam*:

Besa e shqiptarit — si purteka e arit.

Mbrojtja e atdheut — detyrë mbi detyrat.

Aksioni — shkollë e madhe edukimi.

Shënim. Kur mungesa e foljes *jam* ose e çdo foljeje tjetër është e lidhur me kontekstin, d.m.th. kur s'përsëritet se është përdorur më përpara, nuk vihet as vizë, as ndonjë shenjë tjetër pikësimi:

Djali im është i mirë, kurse yti shpirt njeriu.

Në krah mbante një torbë e në dorë një shkop të thatë thane.

§ 133. Viza mund të përdoret edhe para një ndajshtimi të veçuar me kuptim saktësues për ta vënë në dukje më shumë, sidomos kur ndahet nga gjymtyra e përcaktuar prej fjalësh të tjera ose prej një fjalie përcaktore (në këto raste në vend të vizës mund të përdoret edhe presja; shih § 53,2).

Në xhunglën revizioniste dhe antimarksiste shohim që mbiu edhe një *teori* tjetër — **teoria e «tri botëve»**, e cila paraqitet si një teori e re, por që, në realitet, është shumë e vjetër (E. Hoxha).

Pikërisht këtë kriter klasor zbatoi Lenini, kur përcaktoi, pas Revolucionit Socialist të Tetorit, se tani në botë ka dy botë: **bota e vjetër — kapitalizmi**, dhe **bota e re** që po rritet — **socializmi** (E. Hoxha).

§ 134. Mund të ndahet me vizë edhe një përemër a ndajfolje me kuptim përgjithësues që vjen pas vargut të gjymtyrëve homogjene, për ta vënë në dukje më shumë (shih § 43 shënimi 2):

Dashuria dhe malli për atdheun, për shtëpinë, për vatrën — ja cilat kanë qenë gjërat më të shenjta për poetin.

Kurorat e pishave që ngjiteshin lart dhe bashkoheshin me

shoqja-shoqen, zogjtë që fluturonin mbi kaltërsinë e tyre, era e rrëshirës fieri i dendur që më guduliste kërcinjtë, gurgullimi i përroit — të gjitha këto nuk më bënë asnjë përshtypje.

§ 135. Viza mund të përdoret në vepra shkencore, rregullore, udhëzime etj. para fjalive a periudhave që nisin me kryeradhë dhe që rreshtojnë argumentime, fakte, përfundime, detyra etj.:

Aparati pedagogjik i këtyre teksteve ka shumë funksione. Ndër më kryesoret janë:

- të bëhet një mjet i fuqishëm për formimin e elementeve të botëkuptimit materialist-dialektik të nxënësve në përputhje me moshën;
- t'i udhëheqë e t'i aftësojë nxënësit për të shikuar çdo fakt, ngjarje a fenomen nga pozita klasore revolucionare;

— ...

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
PARATHËNIE	3
PIKA (§ 1—17)	9
PIKËPYETJA (§ 18—31)	17
PIKËÇUDITJA (§ 32—42)	21
PRESJA (§ 43—88)	27
Përdorimi i presjes në fjali (§ 43—64)	27
Përdorimi i presjes në periudhë (§ 65—88)	37
PIKËPRESJA (§ 89—95)	51
DY PIKAT (§ 96—105)	57
SHUMËPIKËSHI (§ 106—115)	61
THONJËZAT (§ 116—120)	65
KLLAPAT (§ 121—123)	69
Kllapat e rrumbullakëta (§ 121—125)	69
Kllapat katrore (§ 126—128)	72
VIZA (§ 129—135)	73